



# Mbrojtja

Viti i 88-të i botimit  
Korrik 2020/ Nr. 7



**Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka:**  
Shqipëria konfirmon praninë e saj në  
Kosovë, Afganistan dhe Letoni



**Kompania "Lockheed Martin Global Inc" USA**  
Sistemi i Integruar i Vëzhgimit Ajror  
do të modernizojë Forcat Ajrore



**Vendimi Këshillit të Ministrave**  
Ushtarakët, kompensim për  
ushqimin dhe qiranë e banesave



**Ministrja e Mbrojtjes Xhaçka pret homologun kosovar Anton Quni**  
**Xhaçka: "Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes,**  
**marrëveshja që pritet të firmoset së shpejti"**

# Përmbajtja

Numri 7

## MINISTRJA XHAÇKA

- 6** Në tetor starton programi bachelor në AFA

## KOMPANIA "LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC" USA

- 9** Sistemi i Integruar i Vëzhgimit Ajror do të modernizojë Forcat Ajrore

## TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

- 16** Shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike, prioritet i MM dhe FA

## QENDRA E EKSELENCËS SË NATO-s

- 21** Mësimet e nxjerra dhe mbështetja në kushtet e COVID-19

## QKMBMFA

- 23** Pas javëve të vështira të pandemisë, fëmijët u kthehen pasioneve

## STAFI

### DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

### Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA

Saimir ALIJA

### Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



## 4 TAKIMI

**Xhaçka: Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes, marrëveshja që pritet të firmoset së shpejti**

Me ftesë të ministres së Mbrojtjes Olta Xhaçka, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni realizoi të premten që kaloi më 19 qershor 2020, vizitën...



## 8 MISIONI

**"Shqipëria konfirmon praninë e saj në Kosovë, Afganistan dhe Letoni"**

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s janë takuar me video konferencë në datat 17 dhe 18 qershor 2020. Ky takim dy ditor ka trajtuar planet për një valë të dytë të koronavirusit...



## 13 VENDIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE

**Usharakët, kompensim për ushqimin dhe qiranë e banesave**

Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 10 Qershor 2020 ka miratuar vendimin "Kriteret dhe masat e kompensimit të qirasë së banesave dhe të ushqimit të ushtarakëve..."



## 25 OPINION

**Analiza dhe trendet e planifikimit ushtarak në brendinë e një krize**

Zhvillimi i fushave thelbësore të shoqërive moderne ka çuar në ndryshime të rëndësishme në fushën e sigurisë. Kështu, elementi ushtarak u kërkohe...



Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

# Mbrojtja



## REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror  
i Ministrisë së Mbrojtjes  
Viti i 88-të i botimit  
Nr. 7/ 2020

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë  
revistë nuk mund të riprodhohen  
elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfitimi, pa  
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

**Botues:**

*Qendra e Kulturës, Medias,  
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe  
Botimeve të Mbrojtjes*

**Adresa:**

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

*Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:*

*[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/  
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)*



# Ministrja e Mbrojtjes pret homologun kosovar Anton Quni

## Xhaçka: Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes, marrëveshja që pritet të firmoset së shpejti

Ministri Quni:  
Shqipëria është  
udhërrëfyese ynë  
drejt integritimeve  
euroatlantike në  
rrafshin e sigurisë  
dhe në rrafshin  
ushtarak.

**M**e ftesë të ministres së Mbrojtjes Olta Xhaçka, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni realizoi të premten që kaloi më 19 qershor 2020, vizitën zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministri Quni me delegacionin e tij u prit me ceremoni të lartë ushtarake nga ministrja Xhaçka dhe stafi i saj i lartë ministror dhe ushtarak. Në takimin dypalësh, ministri Quni u urua nga homologia për detyrën e re e cila shprehu bindjen se me përvojën si udhëheqës ushtarak në karrierë dhe me përvojën politike do të përfaqësojë denjësisht aspiratat e Kosovës për integrimin euroatlantik dhe synimin kombëtar për zhvillimin e forcave ushtarake bashkëkohore.

Ministrja Xhaçka e siguroi homologun Quni për mbështetjen e pakursyer të qeverisë shqiptare për vëllëzërit nga Kosova, bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe

mbrojtjes, si dhe proceset integruese të Republikës së Kosovës, çka ishin edhe disa prej temave të takimit mes dy delegacioneve.

"Dua të nënvizoj diçka që e kam thënë në çdo forum ndërkombëtar, diçka që kryeministri Rama e ka përsëritur në çdo rast që ka pasur dhe që është prej kohësh pozicioni zyrtar i Shqipërisë. Përpjekja për të stabilizuar e zhvilluar rajonin tonë, nuk mund të jetë kurrë e suksesshme pa integrimin e plotë të Kosovës në strukturat euroatlantike. Duke filluar padyshim me anëtarësimin në NATO e duke vazhduar më pas me integrimin në Bashkimin Europian. Qoftë në rrafshin politik e diplomatik, qoftë në atë teknik ne do të jemi krah për krah vëllëzërve tanë duke ndarë të gjithë eksperiencën e Shqipërisë me integrimin në NATO." - u shpreh ministrja Xhaçka.

Ministri Quni nënvizoi se për Kosovën, krahas partneritetit me miqtë e përherëshëm si SHBA, Mbretëria e Bashkuar,







Gjermania, Turqia , Shqipëria është aleati i natyrshëm në rrugëtimin drejt anëtarësimit në organizatat rajonale të sigurisë, programin për partneritetin për paqe dhe për t'u finalizuar me integrimin në NATO.

Ai vlerësoi rolin e Shqipërisë në mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës duke e konsideruar vendin tonë si bashkëpunëtorin më të mirë. "Ju jeni udhërrëfyesi ynë drejt integritimeve euroatlantike në rrafshin e sigurisë dhe në rrafshin ushtarak

e Republikës së Shqipërisë."-theksoi ministri Quni.

"Objektivi kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes, pas kalimit në misionin e ri të FSK-së është përmbushja e detyrave të përcaktuara në Planin e Tranzicionit të FSK-së në forcë ushtarake, e cila do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj pa dallime etnike, kulturore, religjioni etj", - tha ai.

Në vazhden e diskutimeve me interes për të dy ministrat, ishte

një deklaratë për shtyp, ku theksi kryesor ishte thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit bilateral dhe rritja e mbështetjes në të gjitha fushat, respektivisht realizimit të Planit të Bashkëpunimit Bilateral në mes dy ministrive. Gjithashtu, Ministri Quni theksoi se duke ditur faktin se trajtimi i temave me interes të përbashkët nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes është shumë e gjerë, ftoi ministren Xhaçka për vizitë të ndërsjelltë në Kosovë. Me nismën e ministres Xhaçka, Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë dhe ajo e Republikës së Kosovës, do të hapin një kapitull të ri dhe shumë intensiv bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes, i cili fillon me negociimin në një kohë sa më të shkurtër të një marrëveshjeje të re bazë mes dy dikastereve, që siç u shpreh ministria Xhaçka, shpreson ta firmosë gjatë vizitës së ardhshme në Prishtinë.

Pas takimit në Ministrinë e Mbrojtjes, delegacioni, i shoqëruar nga zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, vizituan Muzeun Historik të Forcave të Armatosura. Gjatë vizitës, delegacioni i Ministrit Quni përbëhej nga Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Irfete Spahiu, ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë Nait Hasani, atashëu ushtarak, kolonel Bashkim Shillova, Drejtori i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritime Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha, zyrtarja e lartë, Martina Dedaj Kçira si dhe këshilltarët, Feriz Trezhnjeva dhe kolonel Hamdi Pollomi.



dhe me plot bindje e them se ne ju konsiderojmë si ambasadorin më të mirë, që edhe Forcat e Sigurisë së Kosovës nesër të jenë krah për krah me të gjitha ato forcat që zhvillojnë aktivitete të ndryshme për të ndihmuar të gjithë ata qytetarë që kanë nevojë për siguri dhe për paqe. Unë nuk e di që ka ndonjë adresë më të mirë ku ne mund të kërkojmë bashkëpunimin se sa Ministria e Mbrojtjes

vlerësimi i krizës së pandemisë COVID-19, si sfidë të menaxhuar me sukses nga ana e dy ministrive dhe forcave në mbështetje ushtarake të autoriteteve civile dhe duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm bashkërendimin e aktiviteteve si dhe zbatimin e mësimave të nxjerra në menaxhimin e krizës përkatëse në vijim. Pas takimit mes dy delegacioneve, ministrat Xhaçka dhe Quni dolën në

## Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka:

# Në tetor starton programi bachelor në AFA

**N**ë kushte të veçanta dhe në një situatë tërësisht të pazakontë të krijuar nga pandemia COVID-19, duke respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat protokollare, u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të KLO dhe KKSHP. Pesëdhjetë e tre nënkolonelë dhe majorë të FA shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovë përfunduan me sukses vitin akademik 2019-2020 në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Nënkolonelët ndoqën për rreth 1 vit Kursin e Lartë të Oficerit, ndërsa majorët atë të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Në ceremoninë e përfundimit të këtyre dy kurseve, ditën e dielë, 28 qershor 2020, ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, Znj. Olta Xhaçka, SHSHPFA, Gjeneral Brgade Bardhyl Kollçaku, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, Atasheu ushtarak i Kosovës i akredituar në vendin tonë, Kolonel Bashkim Shillova.

Në ceremoninë e organizuar, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, përgëzoi oficerët dhe pedagogët për vullnetin për ta përfunduar vitin akademik edhe kushtet e vështira të diktuar nga pandemia.

“Jemi në prag të një ngjarje vërtet të rëndësishme, që është rezultat i një pune shumë të gjatë e të vështirë nga të gjithë ne. Pasi jemi duke kryer përgatitjet e fundit për të hapur programin bachelor në Akademinë e FA!

Jemi në prag të një momenti kur Akademia e FA do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes dhe modernizimit të FA! Duke shërbyer si një institucion i mirëfilltë publik i arsimit të lartë!

Akreditimi i Akademisë së FA si një institucion i arsimit të lartë,

*Pesëdhjetë e tre nënkolonelë dhe majorë të FA shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovë përfunduan vitin akademik 2019-2020 në Akademinë e Forcave të Armatosura*





nuk është thjesht një mundësi për të përgatitur kuadro më të mirë për nevojat e mbrojtjes e sigurisë. Kjo është edhe një mundësi e jashtëzakonshme për të thithur talente të reja në familjen tonë, djem e vajza që do të shohin tek FA mundësinë reale për të ndërtuar një karrierë, si profesionistë të arsimuar. Një karrierë që më të aftët e të talentuarit prej tyre mund t'i çojë shumë larg e shumë lart, përtej radhëve të FA sonë, e deri në zyrat e Aleancës ku ne bëjmë pjesë." - u shpreh ministria Xhaçka.

Në fjalën e tij, komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, vlerësoi përkushtimin dhe seriozitetin e treguar, si nga e studentëve, e stafit akademik, personelit mbështetës në përvojën e re të krijuar nga situatë e pandemisë, duke e parë si sfida që Akademia të jetë e përgatitur dhe në gjendje që të reagojë shpejt dhe me cilësi me çfarëdo lloj situatë.

"Sfida tjetër më e madhë për akademinë, - ka vijuar gjeneral Begaj, ka qenë dhe ristrukturimi i saj në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. Në vijim të hapave të ndermarra për vënien në zbatim të VKM për statusin e akademisë tashmë është përfunduar procesi ligjor për hapjen e programit bachelor, duke kaluar në fazën e miratimit zyrtar të përfshirjes në formularët e aplikimit të maturantëve, duke e bërë kështu të aksesueshëm për të gjithë ata që dëshirojnë të bëhen pjesë e FA".

Në përfundim, ministria Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kolçaku, komandanti i KDS gjeneral brigade Bajram Bega dhe atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në Tiranë, kolonel Bashkim Shillova i dorëzuan diplomat kursantëve më të spikatur. Kursin e Lartë të Oficerit e ndoqën 17 nënkolonelë, mes të cilëve 2 nga Forca e Sigurisë së Kosovës, ndërsa Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm e ndoqën 36 majorë, 6 prej të cilëve nga FSK.

## MINISTRJA XHAÇKA:

# Oficerët e rinj të FA diplomohen në SHBA

Ministria Xhaçka vlerëson se oficerët nga Shqipëria u graduan me master në Amerikë, duke i bërë ata personel të FA të Shqipërisë, një nder i veçantë për Forcat tona të Armatosura.

Postimi i Olta Xhaçkës: Një e ardhme e mrekullueshme i pret Forcat e Armatosura me arsimimin e oficerëve të rinj në akademitë ushtarake më elitare të SHBA. Por një e ardhme dhe mundësi po kaq të mira i presin të gjithë ata të rinj e të reja që kanë vullnet dhe duan të bëhen pjesë e FA shqiptare.

Majorët Enkelejda Tyrku e Ermir Bejdo përfunduan kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Leavenworth, Kansas, ndërsa kapiteni i Rangut të III Blerim Hoxha e përfundoi në Neëport, Rhode Island. Dhe mbi të gjitha, na bënë krenarë duke u pajisur të tre me diploma masteri në fushën e studimeve strategjike!



# Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka: “Shqipëria konfirmon praninë e saj në Kosovë, Afganistan dhe Letoni”

“Po punojmë për një mision të përbashkët në Irak në kuadër të Kartës së Adriatikut, drejtimin e së cilës e ka vendi ynë.” - u shpreh ministrja në Ministerialin e Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s

**M**inistrat e Mbrojtjes të NATO-s janë takuar me video konferencë në datat 17 dhe 18 qershor 2020. Ky takim dy ditor ka trajtuar planet për një valë të dytë të koronavirusit, si dhe çështje të tjera kyçe, siç janë rezistenca, misionet ,operacionet , frenimi dhe mbrojtja. “Ne përballemi me sfida globale, kështu që duhet të marrim një qasje globale, për t'i trajtuar ato edhe më në mënyrë efektive.” - tha sekretari i përgjithshëm Jens Stoltenberg. “Ne do të vazhdojmë të sigurojmë që parandaluesi bërthamor i NATO-s të mbetet i sigurt, dhe efektiv.” -tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai kujtoi se, “NATO gjithashtu mbetet fuqimisht e angazhuar për kontrollin efektiv të armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen, të cilat japin një kontribut kryesor për sigurinë tonë.” Shqipëria rikonfirmon pjesëmarrjen e saj në të gjitha misionet, ku Forcat e Armatosura janë të angazhuara. Kështu ka theksuar ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka gjatë Ministerialit të Mbrojtjes të 30 vendeve anëtare të NATO, i mbledhur për të dytën herë online për shkak të COVID-19.

Ky takim ishte parashikuar që të mbahej në Tiranë, por pandemia e

tre muajve të fundit bëri të pamundur organizimin në vendin tonë, të një prej eventeve më të rëndësishme vjetore të Aleancës.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka gjatë fjalës së saj, tha se,- “Shqipëria konfirmon praninë e saj në Kosovë, Afganistan, Letoni dhe po punojmë për një mision të përbashkët në Irak në kuadër të Kartës së Adriatikut, drejtimin e së cilës e ka vendi ynë. Vlerësim për burrat dhe gratë në uniformë, kontributi i të cilëve janë siguria që misionet e operacionet të vazhdojnë pavarësisht pandemisë”.

Ministrja e Mbrojtjes propozoi fokus të veçantë të NATO-s për mbrojtjen dhe deterrancën në krahun jugor të Aleancës. Duke vlerësuar rolin vendimtar që NATO ka në mbrojtjen e rendit global, bazuar në vlerat e përbashkëta, ministrja e Mbrojtjes tha se një aleancë e bashkuar dhe solidare është përgjigja më e mirë ndaj çdo rivali gjeopolitik të NATO-s.

Në qendër të diskutimeve të dy ditëve të Ministerialit, ishin misionet e operacionet e NATO-s si dhe mbrojtja e deterrancës në Aleancën më të madhe ushtarake në botë. Të enjtitjen, ministrat e Mbrojtjes së NATO kanë diskutuar mbi masat që po merren për fazën e dytë të pandemisë në vendet e aleancës. “NATO po përgatitet për një valë të dytë të mundshme të COVID-19.” - tha Sekretari i Përgjithshëm, duke treguar planin e ri të funksionimit të NATO-s, një stok të pajisjeve mjekësore dhe një fond për të marrë furnizime mjekësore në një njoftim të shkurtër. Si një shenjë solidariteti në të gjithë Aleancën, më shumë se gjysmë milioni trupa kanë mbështetur përgjigjen e deritanishme, duke ngritur gati 100 spitale në terren. “Që nga fillimi i pandemisë COVID-19, NATO dhe forcat e armatosura të Aleatëve kanë luajtur një rol kryesor në mbështetjen e përpjekjeve civile.” - tha Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg.





# Sistemi i Integruar i Vëzhgimit Ajror do të modernizojë Forcat Ajrore

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Editson Zarka inspektoi venddislokimin në malin e Midës, Pukë, më 5 qershor, kantierin e punimeve kryesore të implementimit dhe ndërtimit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit Ajror (SIVHA).

Në vendinstalimin kryesor, gjeneral brigade Kollçaku u takua me ekipet specialiste, kontraktorët zbatues të projektit, si dhe u njoh nga afër me paraqitjen aktuale të fazave të punimeve, duke garantuar që çdo punim do të kryhet brenda afateve kohore dhe me kualitetin më të lartë, padyshim lidhur kjo edhe me vete rëndësinë e këtij projekti.

Punimet kanë filluar vitin që kaloi. Në njoftimin zyrtar të datës 29 tetor 2019, të Forcave Ajrore, publikuar në web-in e Ministrisë së Mbrojtjes, thuhet se: - "Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore të RSH (SIVHA), faza I, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe kompanisë "Lockheed Martin Global Inc.", USA, në venddislokimin në malin e Midës, Pukë, po vijojnë punimet për instalimin e radarit të ri me parametrat e NATO. Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Editson Zarka inspektoi punimet civile që po realizohen nga kompanitë nënkontraktore për montimin e bazamentit të kullës, ku do të vendoset radarit dhe elementët mbështetës të tij."

Ndërkohë në vizitën e saj në SHBA, me ftesë të ish-sekretarit amerikan të Mbrojtjes James Mattis, në prill 2018, ministrja e Mbrojtjes, sipas njoftimit zyrtar të datës

*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, inspektoi kantierin e punimeve për ndërtimin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit Ajror (SIVHA)*



17 prill 2018, është takuar dhe me përfaqësues të kompanisë amerikane, Lockheed Martin, kompani elitë në botë në fushën e industrisë ushtarake. Aktualisht "Lockheed Martin", po punon për Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare (SIVHA). Kontrata për blerjen e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit Ajror (SIVHA) u miratua në nëntor 2017.

Sipas njoftimit zyrtar, Ministria Xhaçka u shpreh se Sistemi i Inte-

gruar për Vëzhgimin e Hapësirës Ajrore është me rëndësi, jo vetëm për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, por për të gjithë aleancën e NATO-s. "Jemi të interesuar për praninë e investimeve të mëtejshme të industrisë ushtarake amerikane në Shqipëri. Sistemi i integruar për vëzhgimin e hapësirës ajrore është me rëndësi, jo vetëm për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, por për të gjithë aleancën e NATO-s." - theksoi Xhaçka.

## Deri tani 9 efektivë të prekur, 4 në KFOR dhe 1 në Afganistan

*Gjeneral Brigadë Kollçaku në Komisionin e Sigurisë: Sipas udhëzimeve të NATO-s, ne jemi të përgatitur dhe për një valë të dytë*

**Q**ë nga fillimi i pandemisë së COVID-19, 9 pjesëtarë të Forcave të Armatosura Shqiptare kanë rezultuar të prekur. Shefi e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneralbrigadë Bardhyl Kollçaku gjatë një seancë dëgjimore në Komisionin e Sigurisë foli ditën e martë me 16 qershor lidhur me numrin e të prekurve në rradhët e ushtrisë.

Kollçaku tha se :-"Ministria e Mbrojtjes po risheh kapacitetet shëndetësore dhe rezervat materiale për pandeminë ,por edhe pas tërmetit të 26 nëntorit. Mund të themi që edhe mbas tërmetit të vitit të kaluar, Ministria e Mbrojtjes po risheh kapacitetet tona. Mund të përforcohen kapacitetet shëndetësore, apo krijimi i rezervës material ,që në krye të herës ka qenë një bashkëpunim shumë i mirë. Task Forca e Ministrisë së Mbrojtjes ka pasur bashkëpunim me atë të Policisë dhe Ministrisë së Brendshme. Asnjë incident nuk kemi pasur. Kemi bërë një harmonizim të pikave të forta, ka qenë shumë i mirë. Dua të falënderoj strukturat e policisë që kanë qenë bashkëpunues."

"Personeli i njësisë së mbrojtjes, Forcat e Armatosura të infektuar me COVID-19 gjithsej ishin 9 persona. Nga këta 5 në misione, 4 në KFOR dhe 1 në Afganistan ndërsa 4



të tjerët brenda vendit",- u shpreh Kollçaku.

Kollçaku tha se:- "4 prej tyre kanë qenë të shtruar në spitalin e Infektivit në Tiranë, por jo në gjendje kritike serioze. Një person është i karantinuar në Afganistan dhe të tjerët të karantinuar në vendbanimet e tyre.". Ai siguroi se strukturat e mbrojtjes kanë marrë masa edhe për valën e dytë të përhapjes së COVID-19, sipas udhëzimeve të NATO-s. Ne jemi të përgatitur dhe për një valë të dytë,

tha ai. Kollçaku tha se pavarësisht pandemisë Forcat e Armatosura kanë realizuar të gjitha detyrimet dhe vijojnë të jenë në misione dhe operacione. Në një muaj kemi riparë matricën e organizimit vjetor. Kemi filluar stërvitjen, kurset, programet, rekrutimin. Me hapjen e kufijve do të rifillojnë edhe aktivitetet duke u riskeduluar, por FA janë në stërvitje, mision, operacione. Janë në aktivitetet e përditshëm."- konfirmoi Gjenerali i brigadës Bardhyl Kollçaku.

## Atashetë ushtarakë të Italisë dhe Rumanisë

### Përfunduan detyrën kolonel Cornacchia dhe kolonel Tutuianutë

**N**ë mjediset e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, u zhvillua të mërkurën paradite ceremonia e përfundimit të detyrës, të atashet ushtarak të Republikës së Italisë, kolonel Fabio Cornacchia dhe atashet ushtarak të Republikës së Rumanisë, kolonel Florin Tutuianutë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigadë Bardhyl Kollçaku,

drejtor drejtorish në MM dhe SHP-FA, dhe atashet ushtarak i SHBA në vendin tonë, kolonel James Hilton.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigadë Bardhyl Kollçaku në përshëndetjen e tij pasi i falënderoi të dy atashetë për kontributin e tyre në drejtim të bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes midis vendit tonë, Italisë dhe Rumanisë, u shpreh ndër të tjera: "Dua t' ju shpreh një falënderim të veçantë për kontribu-

tin dhe ndihmën e dhënë nga këto dy shtete në përballimin e situatave të vështira që kaloi vendi ynë, atë të fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe situatën e pandemisë COVID-19." Ceremonia u përmyll me dhënien nga SHSHPFA "Certifikatë mirënjohje" për dy atashetë. Ushtarakë në shenjë mirënjohje për kontributin e tyre të vyer gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrës së tyre në vendin tonë.



# Pashalimani mund të mbështesë kërkesat operacionale të NATO-s

**P**as deklarimit dhe miratimit të investimeve, të cilat pritet të fillojnë për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës, NATO po studion edhe mundësinë për investime edhe në bazën detare të Pashalimanit.

Kërkesës zyrtare të dorëzuar në tetor të 2019-ës nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cila ka parashtruar planin e qeverisë shqiptare për modernizimin e bazës detare të Pashalimanit, Aleanca e Atlantikut të Veriut deklaroi se ka nisur punën në bashkëpunim me autoritet ushtarake shqiptare, për të përcaktuar mënyrën më të mirë se si kjo bazë mund të mbështesë kërkesat operacionale detare të Aleancës.


NATO iu përgjigj zyrtarisht më 7 qershor 2020, interesit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare lidhur me kërkesën e autoriteteve shqiptare për investim në Pashaliman.

"Autoritetet ushtarake të NATO-s janë duke punuar ngushtë me autoritetet ushtarake shqiptare për të përcaktuar mënyrën më të mirë se si baza detare e Pashalimanit mund të mbështesë kërkesat operacionale detare të NATO-s."-konfirmoi për ATSH-në një zëdhënës i Aleancës.

NATO, tha se e mirëpret mbështetjen e Shqipërisë ndaj planeve dhe sigurisë detare të Aleancës.

"Ne mund të konfirmojmë se NATO ka marrë një letër nga ministrja shqiptare e Mbrojtjes, ku shprehet mbështetja e qeverisë shqiptare për modernizimin e Bazës Detare të Pashalimanit. Ne mirëpresim mbështetjen e Shqipërisë ndaj planeve dhe sigurisë detare të NATO-s nëpërmjet dhënies së aftësive detare të saj për misionet dhe

*Zëdhënësi i Aleancës: Mirëpresim mbështetjen e Shqipërisë ndaj planeve dhe sigurisë detare të NATO-s nëpërmjet dhënies së aftësive detare të saj për misionet dhe aktivitetet e drejtuara nga NATO*



aktivitetet e drejtuara nga NATO."-deklaroi zyrtari i Aleancës.

Për NATO-n, nënvizon zëdhënësi për ATSH-në kjo pasqyron solidaritetin, kohezionin dhe unitetin e përpjekjeve të Aleancës.

"Kjo është në të njëjtën linjë me qëndrimet operacionale të NATO-s dhe pasqyron solidaritetin, kohezionin dhe unitetin e përpjekjeve të Aleancës. Autoritetet ushtarake të NATO-s janë duke punuar ngushtë me autoritetet ushtarake shqiptare për të përcaktuar mënyrën më të mirë se si kjo bazë mund të mbështesë kërkesat operacionale detare të NATO-s."-nënvizohet në reagimin zyrtar për ATSH-në.

Në tetor të vitit të shkuar ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka iu drejtua përmes një letre zyrtare komandantit të Komandës Supreme për Europën, gjeneralit amerikan Tod D. Eölters që Aleanca të konsiderojë Pashalimanin edhe për shkak të gjeografisë dhe avantazheve që ofron, për të investuar edhe aty një bazë detare.

Ministrja ka theksuar se Shqipëria është gati për zbatimin e një plani të përbashkët për zhvillimin e bazës detare për Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Ndërkaq baza ajrore e Kuçovës do të jetë gati së shpejti, sipas projektit të hartuar nga NATO, një investim ky që kap vlerën e 50 milionë eurove.

## Forcat e Armatosura kanë nevojë për profesionistë të rinj!

*Janë 60 të drejta studimi për ata, që kanë arsimin universitar: Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti Juridik, Inxhinierisë Elektronike, Ekonomik, Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Navale, Mekanike, Fakulteti i Mjekësisë, Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi, por dhe për këmbësori edhe fakultetet e tjera*

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka bën me dije se FA janë të interesuara për profesionistë të rinj të sapodiplomuar dhe i fton ata të aplikojnë. Xhaçka thotë se aplikimet pranohen deri më 17 korrik dhe ka disa kritere si dhe një formular vetëdeklarimi me të cilin aplikohet për në Forcat e Armatosura. Të gjithë ata që kanë përfunduar çdo fakultet dhe janë jo më shumë se 26 vjeç kanë të drejtë të aplikojnë. Përjashtim bën Fakulteti i Mjekësisë dhe pranohen ata që janë jo më shumë se 31 vjeç.

Njoftimi i Ministres Xhaçka.

Forcat e Armatosura kanë nevojë për profesionistë të rinj!

Ke përfunduar Fakultetin Juridik, të Shkencave Sociale, të Inxhinierisë Elektronike, Ekonomik, të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Inxhinierisë Navale, Inxhinierisë Mekanike, Gjeoinformatikë e Gjeografi apo çdo fakultet tjetër dhe je jo më shumë se 26 vjeç?

Ke përfunduar Fakultetin e Mjekësisë dhe je jo më shumë se 31 vjeç? Forcat e Armatosura janë një alternativë e jashtëzakonshme për çdo të sapodiplomuar. Plot 60 të rinj që kanë një diplomë bachelor, do mund



të titullohen oficerë dhe të kenë një karrierë të sigurt në Forcat e Armatosura pas përfundimit të kursit 1-vjeçar. Kujdes, aplikimet pranohen deri më datë 17 korrik 2020!

Për këtë Qendra e Personel Rekrutimit, pranë Ministrisë së

Mbrojtjes, më 11 qershor 2010, ka shpallur kriteret për rekrutimin e kandidatëve për të ndjekur studimet për përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020 -2021, për 60 (gjashtëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet vijon: Personel (Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti Juridik), Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike), Logjistikë (Fakulteti Ekonomik), Xhenio (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Pilot (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera).

## FA, pjesë e "Security Force Assistance" në Romë

### FA në Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Forcat e Sigurisë

Delegacioni shqiptar i kryesuar nga ambasadorja e RSH në Itali, znj. Anila Bitri Lani, shoqëruar nga atasheu ushtarak kolonel Ylli Pulaj, zhvilloi më 17 qershor 2020, një vizitë në Qendrën e Ekselencës së NATO, për Forcat e Sigurisë dhe Asistencës (Security Force Assistance) në Romë. Në fokusin e vizitës ishte nxitja e bashkëpunimit mes kësaj qendre dhe Shqipërisë, si një nga vendet sponsorizuese. Përfaqësuesi ynë nënkolonel Haxhija, në pozicionin e shefit të Degës së Mësimeve të Nxjerra, bëri një prezantim për misionin, detyrat, strukturën dhe vizionin e kësaj qendre. Më pas diskutimi u fokusua në gjetjen e mënyrave të reja të mundshme, ndikuar nga situata pandemike, për të mbështetur Forcat e

Armatosura të RSH në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve në fushën e Asistencës ndaj Forcave të Sigurisë, gjatë operacioneve të drejtuara nga NATO në vendet postkonfliktuale.

Ceremonia e inagurimit të Qendrës së Ekselencës së Ndhmës së Forcës së Sigurisë, (NATO SFA COE) Itali është zhvilluar në mars 1919 në Romë, ku mori pjesë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Në përshëndetjen e tij, në këtë ceremoni të veçantë, gjeneral brigade Kollçaku pasi falënderoi gjeneral Vecciarelli, gjeneral brigade Glavaš, ambasadorët, drejtorin e kësaj qendre, kolonel Merlino, të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre e bënë realitet ngritjen e

Qendra e Ekselencës për Asistencë të Forcës së Sigurisë së NATO, NATO Security Force Assistance Centre Of Excellence, (NATO SFA COE) është struktura më e re e akredituar nga NATO dhe e 25-ta në rrjetin e qendrave të ekselencës të krijuara në vende të ndryshme anëtare të Aleancës dhe krijimi i saj erdhi si domosdoshmëri në mbështetje të konceptit të ri strategjik të Aleancës. Shqipëria është shteti i parë që mbështeti fuqishëm iniciativën italiane dhe së bashku me Slloveninë arriti të jetë një nga nënshkruesit e parë të Memorandumeve të Mirëkuptimit më 13 dhjetor 2017, duke bërë të mundur që të konvergojnë interesat kombëtare në një drejtim me ato të Aleancës dhe të ndërmarrin një linjë të përbashkët veprimi.



# Vendimi Këshillit të Ministrave, datë 10 Qershor 2020

## Ushtarakët, kompensim për ushqimin dhe qiranë e banesave

Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura që, për shkak të detyrës emërohet ,ose transferohet larg vendbanimit dhe nuk është trajtuar me banesë, apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes dhe kur ai ,ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese deri në 3 (tre) vjet.

**K**ëshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 10 Qershor 2020 ka miratuar vendimin "Kriteret dhe masat e kompensimit të qirasë së banesave dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Vendimi është marrë me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Vendimi i mësipërm është firmosur nga kryeministri Edi Rama.

### **Qiraja, 70-80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut**

Sipas vendimit të mësipërm ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura që, për shkak të detyrës emërohet ,ose transferohet larg vendbanimit dhe nuk është trajtuar me banesë, apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes dhe kur ai ,ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton

kompensim për qira banese deri në 3 (tre) vjet.

Masa e kompensimit të qirasë së banesës të jetë 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit garsoniere, kur është beqar ose i martuar dhe pa fëmijë 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 1+1, kur është i martuar dhe ka një fëmijë; 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 2+1, kur është i martuar dhe ka më shumë se një fëmijë.

Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet çdo vit, me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit të Mbrojtjes. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, që përfiton kompensim për qira banese, duhet të paraqesë pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente: kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës, certifikatën personale, nëse nuk gjenerohet nga vetë struktura ushtarake, kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar, vërtetimin përkatës se nuk është trajtuar me banesë apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes, vërtetimin përkatës se ai/ajo ose pjesëtarët e familjes nuk kanë banesë në pronësi. Këto dokumente rifreskohen çdo vit.

### **Ushqimi, ushqim i gatuar ose kompensim financiar në lekë vetëm për vaktin e drekës**

Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura gëzojnë të drejtën e kompensimit financiar në vlerë në lekë, për trajtimin me ushqim vetëm për vaktin e drekës, sipas vendimit nr.88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave,



Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për ditët efektive të punës. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, në raset kur thirren në repart për nevoja shërbimi, ruajtjeje, gatishmërie, stërvitjeje ose fushimi mbi 8 orë, trajtohen me ushqim të gatuar ose kompensohen në vlerën në lekë të këtij ushqimi, aty ku nuk është i mundur ofrimi i këtij shërbimi, sipas normës së përcaktuar në vendimin nr.88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Përzgjedhja e formës së trajtimit me ushqim ose e kompensimit në vlerë në lekë për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, sipas pikës 6, të këtij vendimi, përcaktohet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes. Masa e vlerës për kompensimin e ushqimit përcaktohet çdo vit me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në bazë të kostonë së ushqimit të gatuar dhe të vlerës kalorike të përcaktuar në vendimin nr.88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.524, datë 30.7.2004, për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar, dhe nr.668, datë 7.8.2013, për trajtimin me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për disa ndryshime në vendimin nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shfuqizohen.

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

## FA stërvitje me marinsat amerikanë në Bizë

Forcat e Armatosura kanë treguar profesionalizmin e tyre gjatë stërvitjes së fundit, të zhvilluar me marinsat amerikanë në Bizë. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka njoftuar se stërvitja konsistonte në dërgimin e ngarkesave ajrore dhe qitje reale. "Forcat e Armatosura shqiptare treguan edhe njëherë profesionalizmin, ndërvetprueshmërinë dhe aftësitë e tyre gjatë stërvitjes me marinsat amerikanë në Bizë", - bëri të ditur Xhaçka.



"Stërvitja konsistonte në dërgimin e ngarkesave ajrore dhe qitje reale, ndërkohë që Shqipëria konfirmohet si një aleate e vyer në NATO dhe faktor stabiliteti në rajon.", - tha Xhaçka.

### Akademia e Forcave të Armatosura

## Prezantohen temat studimore për vitin akademik 2019-2020

Referuar udhëzuesit akademik mbi përgatitjen e temave studimore/kursore dhe dokumentit Procedura Standarde Veprimi për përgatitjen, mbrojtjen dhe prezantimin e temave kursore me kursantët e KLO dhe KKSHP për vitin akademik 2019-2020, në AFA u zhvillua prezantimi përkatës. Prezantimet e kursantëve vijuan në të gjitha departamentet, atë të Strategjisë dhe Historisë, Lidershipit dhe Shkencave Sociale, të Operacioneve, si dhe nën drejtimin e udhëheqësve dhe bashkëpunorëve të temave studimore.

Nga ana e stafit drejtues dhe atij mbështetës të KDS/AFA, për një ecuri normale të procesit të prezantimeve të temave studimore, u morën të gjitha masat paraprake mbi zbatimin e protokolleve shëndetësore e distancimit fiziko-social, në lidhje me masat parandaluese të COVID-19, duke zbatuar të gjitha udhëzimet përkatëse për këtë qëllim.





**A**kademia e nënoficerëve "Thomson" ka rinisur në mjedise të hapura, duke respektuar masat anti COVID-19, kurset fillestare dhe të avancuara të nënoficerit.

Lajmin e bëri të ditur me 14 qershor ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cila u shpreh se:- "Akademia e Nënoficerëve "Thomson" është fidanishtja e përgatitjes së drejtuesve të rinj, duke u mësuar efektivëve jo vetëm koncepte dhe veprime luftarake, por edhe leadership".

"Akademia ka rinisur në mjedise të hapura, duke respektuar masat anti COVID-19, kurset fillestare dhe të avancuara të nënoficerit për të rritur më tej profesionalizmin e Forcave të Armatosura", -tha ministria Xhaçka. Kolonel Elton Bregu, Komandant i Akademisë së Nënoficerëve u shpreh se :- "Prej datës 1 qershor ka filluar kursi fillestar i nënoficerit dhe kursi i avancuar. Në kushtet e pandemisë jemi detyruar që mësimin ta zhvillojmë në terren. Çdo kursant paraqitet me maskë dhe mjetet mbrojtëse. Kemi aplikuar dizinfektantë në vendet ku zhvillohet mësim është bërë matja e temperaturës. Misioni i Akademisë së Nënoficerëve është të përgatisë oficerë në FA dhe fokusi kryesor i këtij institucioni arsimor është lidhshipi ushtarak", - tha ai.

Ndërsa, tetar Gazmir Dajti tha se :- "Ky kurs është mjaft i rëndësishëm në karrierën e nënoficerit dhe gjithashtu është kriter për promovimin tonë në gradë. Një nga objektivat e këtij kursi është puna në grup dhe rritja e aftësisë së komunikimit të secilit kursant. Objektivi im personal është që në këtë kurs të jap maksimumin dhe të dal me rezultat të shkëlqyera", - tha ai. Kurse ushtarakja IV Kristjana Mitaj tha se:- "Ky është kursi që hedh hapat e pare për karrierën e nënoficerit në Forcat e Armatosura. Detyrat janë teorike dhe praktike. Këtu mësojmë si të bëhemi një drejtues grupi".

Ky është kursi i 65-të fillestar të nënoficerit, si dhe kursi 44-të i Avancuar i Nënoficerit i ndërprerë për arsye të pandemisë Covid-19. Pjesëmarrës në Kursin Fillestar

## Ka filluar kursi fillestar i nënoficerit dhe kursi i avancuar

*Ministria Xhaçka: Akademia e Nënoficerëve "Thomson" është fidanishtja e përgatitjes së drejtuesve të rinj për Forcat e Armatosura*



te Nënoficerit janë kursantë me gradën UPR IV, të cilët për një periudhë 5-javore do të marrin njohuritë e duhura teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuara me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues. Përfundimi i këtij kursi mundëson titullimin nënoficer aktiv dhe gradimin nëntetar.

Mësimi dhe stërvitja po zhvillohen duke respektuar udhëzimet e dhëna në lidhje me masat parandaluese ndaj "COVID-19". Aktualisht në Akademinë e Nënoficerëve "Thomson", ndjekin kurset 84 kursantë përkatësisht në Kursin Fillestar të Nënoficerit 50 kursantë dhe në Kursin e Avancuar të Nënoficerit 34 kursantë.

## Trupat tanë në Letoni, në stërvitjen "Baltic Warrior"

**G**rup-batalioni i NATO-s në Letoni ku bën pjesë edhe kontingjenti shqiptar, detyrë parësore ka gatishmërinë dhe operacionalitetin. Trupat e këtij batalioni, të përbërë nga 9 vende morën pjesë në stërvitjen "Baltic Warrior", ku më shumë sesa garuan me njëri-tjetrin, fuqizuan forcën e skuadrës dhe përgatitjen e tyre fizike", -shkruan ministria Xhaçka në facebook më 12 qershor 2020.



## Stërvitja individuale, 127 rekrutë të rinj rifillojnë stërvitjen në Bunavi

Në kuadër të zbatimit të masave organizative dhe administrative gjatë zhvillimit të procesit mësimor/stërvitor në institucionet e KDS për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, sipas urdhërit të brendshëm për këtë qëllim, ditën e dielë më 14 qershor u bë pritja e 127 rekrutëve të rinj, nga të cilët 10 vajza, që do të rifillojnë stërvitjen individuale bazë në Shkollën e Trupës (SHT) Bunavi, Vlorë.

Personeli shëndetësor i KDS në bashkëpunim me Njësinë Mjekësore Ushtarake dhe Institutin e Shëndetit Publik, realizuan në mjedisin e hapur të garnizonit "Skënderbej" kontrollin paraprak shëndetësor të personelit kandidat për ushtar/detar, para nisjes së tyre për në Shkollën e Trupës, Bunavi, Vlorë.

Kontrolli paraprak shëndetësor konsistoi në matjen e temperaturës, marrjen e kampionit për COVID-19, si dhe plotësimin e formularëve të deklarimit të situatës shëndetësore për çdo rekrut, në momentin e paraqitjes së tyre.



Për një zhvillim normal të procesit stërvitor në SHT Bunavi, Vlorë, nga ana e stafit drejtues dhe instruktues, do të vijohet me zbatimin e protokolleve shëndetësore, për dizinfektim ambientesh,

infrastrukturës stërvitore e akomoduese, zbatimin e rregullave të distancimit fiziko-social, si dhe në rast të një konstatimi të mundshëm prezence virusi, zbatimin e protokolleve përkatëse.

## Krimi kibernetik dhe teknologjia e informacionit

### Shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike, prioritet i MM dhe FA

Në kushtet aktuale dhe sidomos vitet e fundit shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike është një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura duke bashkëpunuar me aleatët dhe vendet antare të NATO-s.

"Me zhvillimin e teknologjisë kanë evoluar edhe konceptet e sigurisë dhe mbrojtjes. Për këtë Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura i janë përshtatur sfidave të reja. Një armatë e tërë ushtarakësh e civilësh të padukshëm punojnë përditë për të siguruar të dhënat sensitive, informacionin dhe komunikimin e klasifikuar të Forcave tona të Armatosura, si një strukturë, pjesë e një organizate madhështore si NATO." -thotë ministria Xhaçka.



Kolonel Hamdi Doda, komandant i ASNI thote se:- "Krimi kibernetik është i lidhur me fusha të shumta të teknologjisë dhe informacionit, pra është një mjedis kompleks që lind nga nënveprimi i njerezve, i programeve dhe shërbimeve në internet. Me anë të paisjeve dhe rrjedhjeve të teknologjisë ,por që nuk ekzistojnë në formë fizike, mbrojtja kibernetike përdoret kryesisht në kontekstin ushtarak ku ka të bëjë me aktivitete kriminale siç është spiunimi. Qel-

limet e këtyre sulmeve varen nga marrja e informacionit, përfitimi i aksesit të paautorizuar dhe deri të infiltrimi në paisjet elektronike. Një pjesë e rrjeteve kompjuterike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura janë të ndërveprueshme dhe aksesueshme në internet duke i bërë ato të cënueshme ndaj sulmeve të ndryshme kibernetike. Forca e Armatosur si strukturë e rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes janë objektiv i mundshëm për keqbërësit kibernetik. Për këtë arsye vitet e fundit shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike është prioritet i MM dhe FA. FA shkëmben informacion dhe eksperiencë me NATO-n, aleatët kjo në interes të zhvillimit dhe përmirësimit të aftësive të mbrojtjes kibernetike".



# Certifikohen 60 kursantë në Kursin e 44-të

**J**anë certifikuar më 3 qershor 2020 kursantët e Kursit 44-të Bazë të Nënoficerit në ANO. Kursi është zhvilluar në ANO me një personel prej 60 kursantësh, ku katër prej tyre ishin femra, dhe pati si qëllim përgatitjen e kursantëve me zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njëhsuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatim të urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake.

Programi mësimor i tij përgjatë periudhës 8-javore ishte i fokusuar në aftësimin e nënoficerit në realizimin e kërkesave të funksionit organik të tetarit në kuadrin e strukturës organizative të FA.

Në këtë kurs, nënoficeri merr njohuri teorike dhe praktike për drejtimin e trupave në nivel skuadre. Përvetësimi i leadershipit ushtarak arrihet nëpërmjet moduleve që zhvillohen në akademi si: leadership, drejtim-komandim, formim politik, metodikë - didaktike, histori ushtarak, rregullore, ligjshmëri, taktikë, SHLT, përgatitje zjarri dhe përgatitje fizike.

Ky kurs u finalizua me zhvillimin e stërvitjes së kompaktësimit 12-orësh, me temë "Bovilla 2020". Nëpërmjet kësaj stërvitjeje kompaktësuese u zhvilluan elementët themelorë të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njëhsuara.

Nëpërmjet kësaj stërvitjeje u zhvilluan elementët themelorë të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njëhsuara me të, edukimi dhe përgjegjësimi



Kursi i cili zgjati 8-javë është zhvilluar në ANO me një personel prej 60 kursantësh, ku katër prej tyre ishin femra.



ndaj detyrës dhe gadishmërisë luftarake në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake. Stërvitja filloi me dhënien e urdhërit luftarak për marshim dhe kryerjen e marshimit në këmbë sipas itinerarit të përcaktuar me ide taktike. Kursantët u përballën me situata të ndryshme, si organizimi pritës, veprimet e skuadrës për ngritjen e pikës së kontrollit dhe ngritja e vendndalesës, veprimet e skuadrës në mbrojtje, si dhe veprimet e skuadrës në sulm. Stërvitja u inspektua nga grupi i inspektimit i kryesuar nga Komandanti i ANO-së, Kolonel Elton Bregu. Grupi i inspektimit vlerësoi stërvitjen 12-orëshe dhe mënyren e veprimit të kursantëve gjatë gjithë zhvillimit të stërvitjes, situatave të ndryshme, si dhe gjatë ngritjes së përkohëshme të fushimit. Faza e dytë, ajo e specialitetit, do të zhvillohet në qendrat stërvitore të komandave, njësive dhe reparteve të FA si në Forcën Tokësore, Forcën Detare, Forcën Ajrore, Komandën Mbështetëse dhe Policinë Ushtarakë. Ndërkohë është zhvilluar ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Nënoficerit në Forcat Detare-Pashaliman, Forcat Ajrore-Kuçovë

dhe ato Tokësore.

Komandanti i Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore, kolonel David Rroku, tha në ditën e certifikimit se: "Qëllimi i këtij kursi është përforcimi dhe thellimi i njohurive të dhëna më parë në Akademinë e Nënoficerëve në fushën e udhëheqjes ushtarakë, përdorimin e procesit të drejtimit të trupave, dhënien e njohurive të domosdoshme për drejtimin e skuadrës, apo togës në operacione të ndryshme luftarake apo jo luftarake, marrjen e njohurive bazë në specialitetin këmbësori, si dhe dhënien e njohurive për menaxhimin dhe analizën pas stërvitjes. Ne jemi të ndërgjegjshëm theksoi kolonel Rroku se procesi i trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit po konsolidohet dita ditës, në përputhje me standardet më të përparura të vendeve të NATO-s. Në këtë kuadër edhe objektivi ynë kryesor vazhdon të mbetet rritja e profesionalizmit të personelit mësimdhënës e trajnues duke mundësuar kështu mbështetjen e Forcave të Armatosura me oficer dhe nënoficer të aftë për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale.

## Fillon Kursi i 65-të Fillestar i Nënoficerit

# 50 kursantë në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson”

Në Akademinë e Nënoficerave “Thomson” filloi procesi mësimor me Kursin 65-të Fillestar të Nënoficerit, si dhe rifilloi Kursi 44-të i Avancuar i Nënoficerit i ndërprerë për arsye të pandemisë “Covid-19”.

Pjesëmarrës në Kursin Fillestar të Nënoficerit janë kursantë me gradën UPR IV, të cilët për një periudhë 5-javore do të marrin njohuritë e duhura teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuara me të, si dhe shkëputjen

nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues. Përfundimi i këtij kursi mundëson titullimin nënoficer aktiv dhe gradimin nëntetar. Mësimi dhe stërvitja po zhvillohen duke respektuar udhëzimet e dhëna në lidhje me masat parandaluese ndaj COVID-19. Aktualisht në Akademinë e Nënoficerave “Thomson”, ndjekin kurset 84 kursantë përkatësisht në kursin fillestar të nënoficerit 50 kursantë dhe në kursin e avancuar të nënoficerit 34 kursantë.



**Certifikatë falenderimi për disiplinën dhe profesionalizmin e lartë**

## Nderim për Detashmentin e Mbështetjes Rajonale (DMR) Kukës

Në mjediset e Detashmentit të Mbështetjes Rajonale (DMR) Kukës, u zhvillua një ceremoni falënderimi për disiplinën dhe profesionalizmin e lartë të efektivëve të këtij detashmenti në përmbushjen e detyrave gjatë situatës së krijuar për mospërhapjen e virusit COVID – 19 në qytetin e Kukësit. Në këtë ceremoni mori pjesë prefekti i qarkut Kukës z. Zenel Kuçana, drejtori i Drejtorisë Vendore të këtij qarku drejtues Zef Laska, si dhe perfaqësues të pushtetit lokal, të cilët i dorëzuan certifikatën



e falënderimit komandantit të kësaj DMR, major Kastriot Imeraj. DMR Kukës ka qenë e angazhuar jo vetëm në patrullimin e rrugëve të qytetit në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, por edhe në operacionin humanitar të shpërndarjes së pakove ushqimore për familjet në nevojë për përbalimin e situatës së krijuar nga COVID - 19.



**DITA BOTËRORE E MJEDISIT**

## ANO: Angazhim i efektivëve për gjelbërimin e mjedisit

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të mjedisit, 5 Qershor, e cila ka si qëllim nxitjen e aktiviteteve dhe aksioneve në arritjen e ndryshimeve pozitive mbi mbrojtjen e mjedisit, personel oficer dhe kursant i ANO-së, ditën e sotme u angazhuan në pastrimin dhe higjenizimin e ambjenteve të brendshme, të jashtme të institucionit, territorit si dhe të ambjenteve stërvitore ku zhvillohen stërvitjet.

Situata aktuale që po kalojmë me pandeminë e Covid-19, ka rritur nivelin e ndërgjegjësimit të të gjithëve mbi higjienën vetjake, higjenizimin e ambjenteve të përbashkëta. Jo vetëm për ditën e sotme, por çdo ditë në ANO higjenizohen, dezinfektohen të gjitha këto mjedise. Një nga problematikat që po diskutohet më së shumti në këto ditë, është edhe angazhimi i individëve mbi përmirësimin e cilësisë së ajrit që thithim, duke investuar në gjelbërimin e mjedisit të jashtëm edhe të brendshëm, nëpërmjet rritjes së sipërfaqeve të gjelbëruara duke mbjell pemë, duke sistemuar lulishtet, heqjen e mbetjeve urbane dhe pastrimin e barërave.



# Kontingjenti i V-të i Forcave Speciale dhe Kontingjentit XII paqeruajtës nisen drejt Afganistanit

Në mjediset ushtarake të aeroportit të Rinasit u zhvillua më 15 qershor 2020, ceremonia e përcjelljes së trupave të Kontingjentit V paqeruajtës të Batalionit të Forcave Speciale që do të marrin pjesë në misionin “Resolute Support Mission”, në Bagram, Afganistan dhe Kontingjentit XII paqeruajtës të Batalionit III të Këmbësorisë që do të marrin pjesë në misionin “Resolute Support Mission” në Kabul, Afganistan.

Në këtë përcjellje mori pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai dhe atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë kolonel Şakir Cumhur Somer.

Komandanti i Forcës së bashku me kolonel Somer pasi inspektuan trupat pjesëmarrëse në mision, i përgëzuan ata për përkushtimin dhe kurajën e treguar në përballimin e emergjencës civile të shkaktuar nga pandemia COVID-19, por edhe për djersën dhe mundin e derdhur çdo ditë në stërvitje, sidomos në stërvitjen e fundit paradislouese.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai, u shpreh në fjalën e tij se: - “E veçanta e këtij kontingjenti është se përveç detyrave të zakonshme që do të kryeni në mision, ju do t’u duhet të përbaleni edhe me armikun e padukshëm COVID-19, përballje të cilës ju përgjigjet më së miri edhe në atdheun tuaj. Jam besimplotë se ju do t’ja dilni ashtu siç ja keni dalë gjithmonë në çdo detyrë, stërvitje apo trajnim.” Në përfundim të fjalës së tij gjeneral brigade Mullai ju uroi suksese trupave ushtarak.

“Përcollëm dy kontingjente për në misionin “Resolute Support” në Afganistan. Kontingjenti i Forcave Speciale do të vijojë shërbimin delikat në Bagram, ndërsa trupat e batalionit të III të këmbësorisë do të shërbejnë në Aeroportin e Kabulit. Suksese djema dhe u kthefshi shëndoshë e mirë”, -shkruan ministrja Xhaqka, në facebook.



Kontingjenti i V-të i Forcave Speciale do vijojë shërbimin në Bagram, ndërsa Kontingjentit XII paqeruajtës i Batalionit III të Këmbësorisë do shërbejë në Kabul.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako

## Rreth 301.457 familje përfituan ndihma ushqimore dhe mjekësore

Rreth 238 848 familjeve janë mbështetur me ndihma ushqimore, ndërsa 62 609 përfituan ndihma mjekësore, gjatë periudhës së pandemisë, deklaroi më 16 qershor 2020, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako. Çako raportoi në Komisionin e Sigurisë Kombëtare në lidhje me angazhimin e emergjencave civile në ndihmë të familjeve në nevojë gjatë periudhës COVID-19 dhe masat e marra nga kjo strukturë për t’ju përgjigjur detyrimeve të saj lidhur kjo edhe me situatën e tërmetit.

“Prioritetet e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile kanë konsistuar në ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të situatës së krijuar nga COVID-19, në bashkëpunim sidomos me Ministrinë e Shëndetësisë, ku Drejtori i Përgjithshëm i AKMC është dhe pjesë e Task Forcës, dhe monitorimin e territoreve sidomos atyre që vuanin nga pasojat e tërmetit të 26 Nëntorit”, - nënvizoi Çako.

Në lidhje me masat e marra, Çako theksoi se: - “Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesa ndaj shtetasve në kushtet e pandemisë” Komisioni Qendror për ofrimin e asistencës përcaktoi masat për produktet ushqimore dhe joushqimore minimale dhe llojin e produkteve të asistencës ndaj shtetasve në nevojë, asistencë kjo, e cila nuk u ofrua vetëm për sa i përket ndihmave ushqimore. U përcaktuan dhe format e dhënies së ndihmave dhe ofrimit të asistencës për shtetas në nevojë, pagesat mujore, ofrimi i barnave për gjithë kategoritë e pensionistëve apo të sëmurëve, kategorizimi i përfituesve”.

Sa i përket shpërndarjes së ndihmave, Çako bëri me dije përpara komisionit se: - “Në total nga ndihmat ushqimore të shpërndara nga Ministria e Mbrojtjes, por edhe nga të gjitha njësitë e tjera të pushtetit vendor të angazhuara, kanë përfituar 238.848 familje dhe 62.609 familje përfituan ndihma mjekësore”.



# Ish-reparti ushtarak Nr.5011/45”, 3.300m<sup>2</sup> i kalojnë bashkisë Tiranë

Këshilli i Ministrave, më datë 17.6.2020 ka miratuar vendimin nr.478, mbi “Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda teritorit të pronës nr.99, me emertimin “Ish-reparti ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Keshillit të Ministrave për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.

Vendimi është marrë nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, Për pronat e paluajtshme të shtetit, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore të ndryshuar.

Keshilli i Ministrave vendosi kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m<sup>2</sup>, nga trualli funksional i pronës nr.99, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Keshillit të Ministrave, për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në

“ Botuar në Fletoren Zyrtare  
Nr.117, datë 22.6.2020



përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.

Hiqet trualli funksional dhe objektet, sipas planrilevimit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m<sup>2</sup>, nga trualli funksional i pronës nr.99, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë. Përmasat e pronës nr.99, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr.5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin standard të inventarizimit dhe në planrilevimin që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Për sigurinë dhe ruajtjen e pro-

nës, para fillimit të punimeve, bashkia Tiranë do të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrethimin, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes së pronës e cila i kalon në pronësi, sipas parametrave e kushteve teknike dhe për këtë, të hartohet aktmarrëveshje, ndërmjet bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.



# Qendra e Ekselencës së NATO-s “Security Force Assistance” në Romë

## Mësimet e nxjerra dhe mbështetja në kushtet e COVID-19

Qendra e Ekselencës së NATO-s “Security Force Assistance” në Romë, organizon forumin mësimet e nxjerra dhe mundësitë e reja për bashkëpunim dhe mbështetje në kushtet e krizës pandemike COVID-19, ku mori pjesë edhe Ambasadorja e RSH në Itali, Znj. Anila Bitri Lani.



NGA N/KOLONEL DËFRIM HAXHIJA\*

**N**ë datë 17.06.2020, Qendra e Ekselencës së NATO-s “Security Force Assistance” në Romë, nën drejtimin e Kolonel Massimo Di Pietro, drejtorit të ri të kësaj qendre, organizoi forumin “Mësimet e nxjerra dhe mundësitë e reja për bashkëpunim dhe mbështetje në kushtet e krizës pandemike COVID-19”. Aktiviteti u moderua nga N/Kolonel Dëfrim Haxhija, përfaqësuesi ynë ushtarak, Shefi i Degës së mësimëve të nxjerra të kësaj struk-

ture të NATO-s. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe një delegacion shqiptar i kryesuar nga Ambasadorja e RSH në Itali, Znj. Anila Bitri Lani e shoqëruar nga Atasheu ynë ushtarak Kolonel Ylli Pulaj, nënmasa sigurie dhe mbrojtje shëndetësore në përputhje të plotë me ato të miratuara nga qeveria italiane në urgjencën epidemiologjike të COVID-19.

Vizita e ambasadores i dha mundësinë drejtorit të qendrës për t’i ilustruar asaj aktivitetet kryesore në zhvillim për vitin 2020 duke theksuar potencialin e lartë kërkimor dhe mbështetës që kjo strukturë e NATO-s mund t’i ofrojë institucioneve akademike dhe ushtarake të interesuara. Në këtë kontekst, ai theksoi se prioriteti i parë në përfitimin e rezultateve të arritura nga qendra nëpërmjet projekteve studimore, zhvillimit të koncepteve dhe eksperimentimeve, si dhe edukimit dhe trajnimit në fushën e Asistencës për Forcat e Sigurisë, do të jenë pikërisht vendet sponsore të qendrës, ndër të cilat është edhe Shqipëria.

Vizioni i tij është që ta kthejë qendrën në një pikë qendrore në zgjerimin dhe përmirësimin e aftësive të NATO-



s, anëtarëve dhe partnerëve të tjerë, duke ofruar ekspertizën dhe mbështetjen gjithpërfshirëse jo vetëm në fushën e Asistencës për Forcën e Sigurisë, por edhe në çështje të tjera, që lidhen me përmirësimin dhe forcimin e institucioneve të përbashkëta të sigurisë dhe mbrojtjes.

Duke analizuar situatën aktuale, Kolonel Di Pietro theksoi se prej fillimit të këtij viti e gjithë bota po përballlet me rrethana të pazakonta pune dhe jetese. Të gjitha përpjekjet aktuale reaguese të NATO-s dhe strukturave të saj janë të rëndësishme dhe të domosdoshme, por

Covid-19 LL Campaign". Mbase prezantoi arritjet e deritanishme nga qendra lidhur me mbledhjen e të dhënave, vëzhgimeve dhe mësimave potenciale në lidhje me ndikimin e pandemisë në operacionet jashtë zonës së përgjegjësisë, aktiviteteve të këshillimit, monitorimit dhe trajnimit të forcave lokale të sigurisë në vendet me paqëndrueshmëri politike dhe sociale ku është angazhuar NATO, N/ Koloneli ftoi në debat dy ekspertë mjekësorë Kolonel Elton Reso, Drejtorin e Inspektoriatit Shëndetësor në Sh.P FARSH, i cili sapo përfundoi me sukses kursin për

duke hapur një tjetër dritare bashkëpunimi aq të rëndësishme dhe aktuale në ditët e sotme.

Diskutimi vazhdoi me analizimin e veprimtarive bashkëpunuese të deritanishme me vendin tonë dhe propozimet konkrete mbi gjetjen e mënyrave të reja të mundshme, ndikuar nga situata pandemike, për të mbështetur Forcat e Armatosura Shqiptare dhe institucionet tona arsimore ushtarake në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve në fushën e Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFA), në veçanti në përgatitjen e personelit pjesëmarrës në operacionet e drejtuara nga NATO.



gjetja e mënyrave të reja inovative të komunikimit si dhe identifikimi i mësimave të nxjerra nga kjo përvojë pandemike është me rëndësi thelbësore. Në këtë kontekst edhe qendra po jep një kontribut të vlefshëm duke angazhuar potencialet e saj, nën drejtimin e degës së mësimave të nxjerra, nëpërmjet përfshirjes së aktorëve civilë dhe ushtarakë, shkëmbimit të informacionit dhe analizimit të mësimave të identifikuar dhe grumbulluar nga burime të ndryshme në rang kombëtar dhe ndërkombëtar në përpjekjet reaguese ndaj situatës pandemike COVID-19.

Pikërisht, lidhur me këtë përpjekje, N/Kolonel Haxhija moderoi një seancë të thelluar diskutimesh mbi Mësimet e Nxjerra nga angazhimi i forcave dhe njësisve ushtarake në lidhje me përballimin e krizës aktuale pandemike, për të cilën qendra po mbështet projektin e lançuar nga ACT" NATO

Studime të Larta të Sigurisë dhe Mbrojtjes (IASD) në Romë dhe nga pala italiane Kolonelin Claudio Zanoti, shefi i zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, nga Drejtoria e Përgjithshme Italiane e Shërbimeve Mjekësore Ushtarake (IGESAN), pjesëmarrës në takim.

Kolonel Reso prezantoi studimin e rastit mbi mënyrat e përballjes së aktiviteteve pandemike dhe mbështetjen ushtarake ndaj sistemit shëndetësor shqiptar. Nëpërmjet një analize profesionale dhe statistikore, ai nxori në pah edhe disa mësim të identifikuar dhe praktika të suksesshme gjatë këtij angazhimi. Kolonel Zanoti ndërhyu në debatin akademik duke theksuar shkëmbimin e frytshëm dhe të vazhdueshëm të informacionit dhe bashkëpunimit me autoritetet mjekësore ushtarake shqiptare gjatë menaxhimit të krizës. Diskutimi profesional i dy mjekëve ushtarakë shënoi një vlerë të çmuar në këtë aktivitet,

Kolonel Di Pietro falenderoi Ambasadorin dhe nëpërmjet saj, RSH, Ministrinë e Mbrojtjes dhe SHP për mbështetjen e vazhdueshme, gjë që e dëshmoi edhe kjo vizitë dhe e siguroi, se qendra do të vazhdojë të mbështesë dhe sigurojë që të gjitha produktet dhe shërbimet e saj t'i ofrohen FARSH dhe institucioneve tona të sigurisë nëpërmjet një bashkëpunimi reciprok edhe në të ardhmen.

Ambasadorja e siguroi Kolonel Di Pietron, se Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë vizionin dhe projektet e lançuar nga qendra, si dhe do të ofrojë bashkëpunim jo vetëm me strukturat arsimore ushtarake dhe njësitë tona të angazhuara në misionet e NATO-s, por edhe me institucione arsimore civile dhe akademike të sigurisë kombëtare shqiptare. Ajo gjithashtu shprehu vlerësimin e saj për suksesin e shkëlqyer të këtij aktiviteti, duke ritheksuar vlerën e lartë të qendrës jo vetëm në zhvillimin e aftësive ushtarake shqiptare në SFA, por edhe në kornizën më të gjerë të marrëdhënieve me sferë civile, si një referencë e padiskutueshme për t'u ndjekur nga bota akademike dhe sektori i kërkimit.

\* Shefi i Departamentit të Mësimave të Nxjerra Qendra e Ekselencës për Asistencën e Forcës së Sigurisë



# QKMBMFA

## Pas javëve të vështira të pandemisë, fëmijët u kthehen pasioneve

Gazmend Çaçi:  
Jemi të gatshëm t'u shërbejmë fëmijëve të ushtarakëve për të plotësuar pasionet e tyre në futboll, basketboll, volejboll, pikturë, kanto apo muzikë.

**P**as javëve të vështira të pandemisë, fëmijët e ushtarakëve u kthehen pasioneve duke vazhduar kurset pranë Qendrës Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura. Kjo është përshëndetur edhe nga Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka.

"Në krah të familjeve të efektive të Forcave të Armatosura për më të shtrenjtët e tyre, fëmijët. Pas javëve të vështira të pandemisë, po i kushtohet vëmendje maksimale angazhimit në kurset

e sportit, muzikës apo pikturës, tashmë në natyrë dhe jo në klasa apo palestër. Me nisjen e aktiviteteve sportive nisi edhe stërvitja në basketboll dhe futboll, me të njëjtat rregulla si në skuadrat profesionale", -shkruan ministria Xhaçka në facebook.

Izolimi prej dy muajsh ka ndikuar jo pak tek fëmijët. Ka patur komunikim nëpërmjet rrjeteve sociale ku janë dhënë këshilla për të mbajtur trupin në formë. Ditën e parë që erdhëm në fushë, ditën e parë që kapën penelin për të pikturuar apo që vendosën gishtat mbi penta-





gram, ata u çliruan pak. Fëmijët kanë nevojë për aktivitete për t'ju larguar rutinës apo kalimit të kohës nëpër telefona.

"Në periudhën e izolimit jam marrë me ektivitete të ndryshme, si me piktura. Kam kënduar ndonjëherë. Më mori malli për aktivitetet e ndryshme që bënim, më mori malli për profesorët dhe për shokët e shoqet e kursit",- thotë volejbollistja e vogël. "Tani ndihem me e qetë, luaj me shokët dhe me shoqet. Jam më e lumtur kur luaj me të tjerët. Fëmijët duhet të marrin ajrin e pastër ,që të kenë një trup më të shëndetshëm ", thotë një tjetër.

Kurse ligjenda e basketbollit, Gazmend Çaçi, aktualisht Shef i Sektorit të Aktiviteteve pranë Qendrës Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, thotë se:-"Nga ana psikologjike e mirëpresim ,sepse fëmijët kanë mbetur në zona shumë të ngushta si në shtëpi, brenda dhomave të tyre, prandaj kjo është një gjë shumë e mirë që stërvitjet hapen për femijët. Kështu ne tani duhet të marrim masa edhe më mire që të krijojmë kushte sa më të mira, sepse fëmijët e kanë shumë të domosdoshme. Qarkullimi i gjakut dhe oksigjenit në trupin e femijëve i jep trurit më shumë fantazi dhe ne patjetër duhet të jemi të gatshëm tu shërbejmë femijëve të ushtarakëve për të plotësuar pasionet e tyre në futboll, basketboll, volejboll, pikturë, kanto apo muzikë."



**MINISTRJA XHAÇKA**

## Sa bukur fëmijët e ushtarakëve tanë!

**“**U kënaqën duke garuar me njëri-tjetrin në 10 disiplina të ndryshme, nën mbikqyrjen e trajnerëve tanë dhe Federatës së Atletikës, organizuar në ambjentet e Policisë Ushtarake.

Treguan aftësitë e tyre më të mira të fituara në kurset sportive për fëmijët në Forcat e Armatosura. FA një familje e madhe!”



## Analiza dhe trendet e planifikimit ushtarak në brendinë e një krize

N/kol r Msc Kanan HIMAJ  
Në Qendrën e doktrinave dhe Kërkimit

Siguria shoqërore, një kornizë e re për planifikimin e veprimit ushtarak

Zhvillimi i fushave thelbësore të shoqërive moderne ka çuar në ndryshime të rëndësishme në fushën e sigurisë. Kështu, elementi ushtarak u kërkohet të përgjigjet për detyrat e reja të krijuara nga sfidat e krizave të mundshme që, për shkak të kompleksitetit të veprimeve të aktorëve të përfshirë, do të jetë gjithnjë e më e vështirë për t'u menaxhuar. Përdorimi i FA në zgjidhjen e një situatë krize në spektrin e gjerë shoqëror kërkon analiza dhe tendenca të reja në artin e procesit të planifikimit të mbrojtjes për përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve. Kjo justifikon qasjet e reja konceptuale në lidhje me përdorimin e FA në zona dhe funksione që lidhen me ato elemente të institucioneve përgjegjëse për sigurinë e vendit. Mundësia e shfaqjes së ngjarjeve negative me një ndikim të madh shoqëror, të tilla si një tërmet i fuqishëm në vendit tonë ose Pandemia COVID-19, kanë ndryshuar ndjeshëm rolin e ndërhyrjes dhe në mënyrë të nënkuptuar planifikimin e veprimeve të tyre. Prandaj, administrimi i një krize karakterizohet nga kohëzgjatja dhe efektet katastrofike që mund të çojë në një ose më shumë situata të tjera krizash.

Në këto situata mund të parashikohen dhe parandalohen vetëm në bazë të skenarëve të kërcënimeve të zakonshme dhe me kusht që burimet e përbërësve shoqërorë të përdoren me përgjegjësi dhe me kujdes sipas këtyre skenarëve. Sot, më shumë se kurrë e konsiderojmë si të përshtatshme lidhjen me planifikimin e veprimeve të FA në kontekstin e një krize sepse, ashtu si në rastin e tërmetit të fuqishëm në vendin tonë, pandemisë COVID-19 mund të gjenerojë situata shumë më të ndërlikuara nga këndvështrimi shoqëror.

Rolet që institucionet shtetërore luajnë në sigurimin e jetesës së popul-



latës në kuptimin e zgjidhjes së problemeve të sigurisë sociale theksohen gjithnjë e më shumë. Ne përcaktojmë nocionin e sigurimeve shoqërore si bashkësinë e situatave të ndërlidhura, në të cilat fushat themelore të një shoqërie funksionojnë drejt përmbushjes së kushteve për sigurimin e mallrave dhe shërbimeve jetësore për popullatën të caktuar gjeografike. Termi shoqëror ka fituar kuptime të reja, kur fushat themelore të një shoqërie (politikë/diplomatik, ushtarak, ekonomik, social, mjekësor, infrastrukturë, informacion, kornizë mjedisore dhe gjeo-strategjike) mbivendosen, të cilat, kur dëmtohen, mund të gjenerojnë situata krize, vështirë për tu menaxhuar në një qasje unitare. Mundësia e shfaqjes së ngjarjeve negative me ndikim të madh shoqëror, të tilla janë tërmeti i fuqishëm, ndërprerje e energjisë, furnizimit me ujë ose ndërprerje të gazit natyror, një pandemi, etj. Këto përfshijnë gjenerimin e skenarëve ku secila prej tyre kontribuon në zbutjen dhe daljen nga kriza, proporcionalisht me masën e dëmtimit të tij. Megjithatë siguria moderne nuk është vetëm çështje e kërcënimeve ushtarake që i paraqiten shtetit, elementi ushtarak mbetet standardi për sa i përket mënyrës sesi të luftojë një kërcënim, paravësist nga natyra e tij. Specifike për veprimet ushtarake, konfrontimi bëhet me një armik, veprimet e të cilit synojnë objektivat themelore që rrezikojnë

seriozisht gjendjen e sigurisë së vendit. Në këtë drejtim, janë zhvilluar strategji integrale dhe shumëdimensionale për të hartuar veprimet e reagimit në rast agresioni ,ose një ngjarje negative me ndikim të madh shoqëror. Misioni nën ndikimin e NA5CRO konsiston në arritjen e menaxhimit të krizave, ku nuk ka ndonjë kërcënim të qartë të drejtpërdrejtë për kombet ,ose territorin e NATO-s. Për të sqaruar këtë çështje, janë marrë në konsideratë aftësitë e aleancave të ndryshme për ndërhyrje në rast të një krize, me qëllim lehtësimin e vuajtjeve njerëzore përmes ndihmës humanitare dhe operacioneve ndihmuese nga katastrofat. Pritet që konfliktet e ardhshme të shndërrojnë veprimet e FA sipas natyrës së kërcënimeve konvencionale ,ose jokonvencionale në çdo lloj kombinimi, në mënyrë që arrijnë përfundime të dëshiruara. Kjo përfshin strukturat FA që përgatisin, planifikojnë dhe ekzekutojnë operacione në përgjigje të kërcënimeve të llojeve të ndryshme. Këto kërcënime mund të jenë përveç kërcënimeve ushtarake ose në kombinim me to, siç janë operacionet e reagimit ndaj krizave në rast fenomenesh natyrore siç janë tërmetet, përmbytjet, fenomenet ekstreme natyrore dhe katastrofat e tjera natyrore, si dhe katastrofat e bëra nga njeriu, aksidente industriale, zjarre në shkallë të gjerë, etj.

Kur vëzhgojmë shkaqet e një kon-



flikti dhe veçanërisht mjetet për t'iu kundërvënë atyre, është thelbësore të kuptojmë mjedisin operacional dhe në mënyrë të nënkuptuar shkallën e rrezikimit të secilës aspekt të shoqërisë. Transformimet e sjelljes së fushave të prekura shoqërore mund të shkaktojnë efekte dhe pasoja që mund të gjenerojnë kriza të thella, ose konflikte ushtarake. Ky aspekt bëhet edhe më i komplikuar kur merren parasysh elementët e tjerë me një potencial për të transformuar shoqërinë, të cilat shkaktojnë ndryshime të pakthyeshme, siç janë ndikimi i sëmundjeve infektive ose gjenocidit. Prandaj, është e kuptueshme që asnjë entitet nuk mund të menaxhojë të gjithë komponentët e një kërcënimi të një natyre të vetme dhe komplekse, që nënkupton se ka nevojë për veprime të bashkërenduara të institucioneve civile dhe ushtarake, të të gjithë aktorëve të përfshirë, në një qasje gjithëpërfshirëse. Në këtë kontekst, është e nevojshme të rivlerësojmë dhe ri-analizoni rolet që strukturat ushtarake që mund të luajnë në situata komplekse, përveç konflikteve ushtarake. NATO planifikon disa masa në këtë drejtim duke mbajtur në konsideratë situatat ligjore në të cilat strukturat ushtarake mund të vepronë jashtë nenit 5. Prandaj, NA5CRO i referohet llojeve të ndryshme të operacioneve ushtarake që kontribuojnë në parandalimin e dhe zgjidhjen e konflikteve, menaxhimin e krizave, ose ato që shërbejnë për qëllime humanitare.

Pra, operacionet e përfshira në kategorinë NA5CRO mund të jenë: operacione kërkime shpëtimi, ose mbështetje për evakuimin, operacione për të siguruar lirinë e lundrimit, për mbajtjen në zona të ndërhyrjes ajrore, për të vendosur sanksione dhe embargot, misionet mbështetëse në operacione emergjente dhe humanitare, mbështetje për misionet e stabilizimit dhe rindërtimit, përkatësisht operacionet paqeruajtëse dhe kundër-kryengritjes.

Një vëzhgim i bërë ndaj këtyre analizave tregon se forcat ushtarake thirren për të ndërhyrë në shumë aspekte përveç situatave të luftës. Kjo çon në rishqyrtimin e përcaktimit të mjedisit operacional në kuptimin që spektri i kërcënimeve i cili ndryshohet rrënjësisht dhe përbërësi ushtarak nuk është i përgatitur të planifikojë dhe kryejë operacione në një fushë të panjohur, siç është mjedisi shoqëror. Ky pohim bazohet në faktin se mjedisi shoqëror është ndërtaur rrënjësisht mbi tërësinë e situatave të ndërlidhura, në të cilat të gjitha fushat e një shoqërie funksionojnë për të përmbushur kushtet për sigurimin e mallrave dhe shërbimeve jetësore në një zonë të caktuar gjeografike. Kur jepen shërbimeve jetike ndikohet drejtpërdrejt, ose indirekt, përbërësi ushtarak nuk është më në gjendje të funksionojë në kapacitetin e synuar. Ndodhja e mundshme e një ngjarje negative me një ndikim të madh shoqëror, siç është një tërmet i fuqishëm ,ose Pandemia COVID-19, mund të transformojë ndjeshëm rolin e përbërësve të ndërhyrjes dhe në mënyrë

të nënkuptuar mënyrën e planifikimit të veprimeve ushtarake.

Një vëzhgim tjetër ka të bëjë me atë se si arti i planifikimit të veprimit ushtarak mund të zbatohet në kontekstin e një krize shoqërore. Ky fakt nuk rregullohet drejtpërdrejt në korvizën ligjore, dhe kjo për shkak të mungesës së një situatë reale në të cilën është kërkuar përbërësi ushtarak për të zgjidhur një problem të tillë. Sigurisht, ndërhyrjet e strukturave ushtarake në rast të një tërmeti të fuqishëm, fenomeneve të caktuara fizike natyrore, reshjeve të dëborës ose përmblytjeve, kanë synuar të zbusin pasojat e tyre negative mbi popullatën. Në rast të një pandemie, siç është COVID-19, përbërësi ushtarak mund të ndërhyjë në mbështetjen e autoriteteve qendrore dhe lokale për të imponuar kufizime dhe të zbatojë rregulla të sigurisë. Kjo nuk pasqyron thellësinë e situatave komplekse të krizës në kuptimin që, përveç ndikimit të përhapjes së një sëmundje infektive mbi popullatën, ka element të tjerë ushtarake ,ose operacione për të ndërhyrë në zona ,ose rajone të caktuara. Kombinimi i disa situatave negative shoqërore të cilat vështirë të menaxhohen nga një prej përbërësve institucionale që ka autoritet në fushën përkatëse, mund të çojë në përshkallëzimin e situatës së normalitetit dhe kërkesën për ndërhyrjen e strukturave ushtarake. Kjo mund të bëhet nën mandatin e ndërhyrjes së komponentit ushtarak për menaxhimin e krizës, duke marrë parasysh që të sigurojë përgatitjen e duhur të strukturave të ndërhyrjes në situata të tilla. Prandaj, ia vlen të nxiten vendimmarrësit në menaxhimin e situatave të tilla komplekse të krizës, të identifikojnë ato përputhshmëri midis planifikimit të veprimit dhe specifikës së mjedisit të ri operacional, duke miratuar praktika pune që bazohen në specifikën e situatave reale, në aftësitë më të mira ndërinstitutionale.

Për shkak të karakteristikave të mjedisit operacional shoqëror, një mori situatash komplekse mund të rezultojnë të ndikojnë seriozisht në ofrimin e shërbimeve jetësore për popullatën dhe në mënyrë të nënkuptuar kryerjen e veprimeve ushtarake, pavarësisht nga lloji i tyre. Ajo tregon që secila fushë shoqërore ka një kontribut të veçantë për sa i përket zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë, dhe qasja sistematike nënkupton një rivlerësim të artit të planifikimit të veprimit ushtarak në kontekstin e një krize. Të gjitha varësitë midis fushave shoqërore janë nyjet lidhëse për veprimet e secilit aktor individual dhe mund të përfaqësojnë pikënisje për ngjarje të reja negative, në mënyrë implicite pikat e nxitjes së krizave të tjera. Ky fakt tregon se një situatë mund të fillohet "gabimisht" ose për shkak të mungesës së njohurive në lidhje me sjelljen e aktorëve të caktuar, me ose pa rëndësi fillestare në lidhje me analizën e situatës në një kohë të caktuar. Varësitë midis fushave shoqërore theksohen nga lidhjet dhe nyjet që bëhen nga strukturat e specializuara ushtarake me të

cilat shoqëria si e tërë komunikon në këtë mënyrë (për shembull: strukturat e mjekësisë ushtarake janë të lidhura me fushën mjekësore të shoqërisë, por mund të përfshijë edhe përbërës të tjerë, siç janë transporti ose komunikimi dhe teknologjia e informacionit në fushën ushtarake).

Në kontekstin e lidhjeve të fushave shoqërore, rezultojnë se planifikimi i veprimit ushtarak nuk mund të lihet kur kuptohet shkalla e dëmit të shkaktoar në domenet e tjera të shoqërisë (PMESII (politike/diplomatike, ushtarake, ekonomike, sociale, infrastrukturë dhe informacioni)). Prandaj, rezultojnë se planifikimi dhe kryerja e operacioneve ushtarake duhet të jenë në përputhje me situatat në të cilat zonat shoqërore janë ose mund të jenë. Kjo nënkupton shtrirjen e bazës së të dhënave dhe zhvillimin e procedurave sipas modelit të komunitetit bashkëpunues.

Një vend që kalon një situatë krize është një nga sfidat më të mëdha me të cilat duhet të përballen vendimmarrësit. Identifikimi i zgjidhjeve për situata kritike nuk mund të jetë shuma e zgjidhjeve të identikuara në secilin fushë shoqërore. Komplexiteti i ndikimeve në fushat shoqërore pas shfaqjes së faktorëve të ndikimit/kërcënimit kërkon formulime të përbashkëta të objektivave të mbrojtjes dhe në mënyrë implicite një përshkrim të përbashkët të gjendjes përfundimtare të dëshiruar.

Për shkak të gamës së gjerë të aftësive që komponenti ushtarak që mund të zhvillojë, ai luan rol vendimtar në fushat e PMESII në një situatë krize. Në këtë kontekst, mënyra në të cilën ndërhyrjen përbërësi ushtarak nënkupton rregullime thelbësore në procesin e planifikimit të veprimeve në kuptimin e lidhjes së tij me proceset specifike të vendimmarrjes për fushat e tjera shoqërore.

Së fundi, përfundimi që duhet të nxirret në lidhje me nxitjen e planifikimit të veprimit ushtarak në një situatë krize është mënyra e vlerësimit të situatës. Kjo shënohet nga numri i pacaktuar i aktorëve të përfshirë dhe mënyra e drejtpërdrejtë e veprimeve që ndërmarrin për të zgjidhur situatat negative, specifike për krizën. Edhe pse FA janë të gatshme të kryejnë operacione në kohë paqe, krizë dhe lufte, në rast krize, gjërat janë të ndryshme. E veçanta e një situatë krize është se të gjitha zonat shoqërore janë të prekura dhe aktivitetet e tyre aktuale janë paralizuar. Në situatën e infeksionit masiv të popullatës, si në rastin e Pandemisë COVID-19, elementi kritik ,ose "objektivi i sulmit" përfaqësohet nga personeli, i cili sipas përqindjes së prekur të secilës fushë shoqërore, dmth, është shndërruar në drejtime të reja për fillimin e shpërthimeve të reja të krizave.

Për sa më lartë, në procesin e planifikimit ushtarak në fushën e operacioneve për zgjidhjen e krizave ju del përpara një mori detyrash të rëndësishme të cilat do të kërkojnë intelektualitetin, metodologjinë, metodën dhe mënyrën për të planifikuar detyrat në interes të sigurisë së popullatës.



# Mbrojtja Kundërajrore Shqiptare në 89 vjetorin e krijimit të saj

## Kundërajrori-Arma e suksesshme e Forcave të Armatosura

N/kololonele Figali GOLEMI  
DEGA E BCU-së  
Komanda e Forcës Ajrore

“ Në 1 Korrik 1931 Ushtria Kombëtare shqiptare kishte 680 oficerë, 540 nënoficerë, 5800 ushtarë, por edhe 820 kuaj

### Mbrojtja Kundërajrore shqiptare misionare e suksesit

Krijimi i armës së Mbrojtja Kundërajrore (MKA), e ka zanafillën që me krijimin e shtetit shqiptar sepse toka, deti dhe hapësira ajrore ka qenë dhe mbetet e shtrenjtë dhe e shenjtëruar për ne shqiptarët. Në pikëpamje historiografike pas datës 4.12.1912 që është dita e krijimit të Ushtrisë Kombëtare shqiptare të gjitha armët dhe shërbimet kanë një datëlindje brenda shekullit XX. Ato lindën si domosdoshmëri e kohës, për të plotësuar misionin fisnik të mbrojtjes së truallit shqiptar. Shekulli që shkoi megjithë kompleksitetin dhe problematikën që solli mbart në vetvete një historik të natyrshëm sikurse për gjithë armët edhe për mbrojtjen kundërajrore. Që nga krijimi dhe procesi i zhvillimit të Mbrojtjes Ajrore shqiptare, është i lidhur me zhvillimin e mjeteve sulmuese ajrore, por dhe me domosdoshmërinë për kundërvënien ndaj këtyre mjeteve. Udhë e armëve të ushtrisë sonë, përfshi edhe Mbrojtjen Ajrore lidhet me përshtatjen me gjendjen, mundësitë, detyrat dhe objektivat e kohës. Shteti Shqiptar që lindi më 1912-tën, dëshmoi vullnet dhe seriozitet për vet domosdoshmërinë e rolin e armëve kundërajrore për shkak të zhvillimeve fillestare të aviacionit në vendet fqinje të vendit tonë si në Itali në pragun e Luftës së Parë Botërore. Fqinjët tanë matanë Adriatikut dispononin një trupë pilotash rreth 150 pilotë dhe rreth 100 avionë të blerë. Më 5 qershor 1920 deri më 3 shtator 1920, në Luftën e Vlorës, para një shekulli, u shfaqën



elementet fillestare të mbrojtjes ajrore.

### Durrësi, Shëngjini dhe Sarandë- me histori 89 vjeçare të MKA-së

Akti i parë për mbrojtjen ajrore shqiptare ishte dekreti mbretëror 89 vjet më parë në Tiranë, në Tiranën kryeqytet vetëm 11 vjeçar, të vendosur në Kongresin e Lushnjës. Më 1 korrik 1931, shpallet dekreti mbretëror, që ndryshe quhej dhe akti ligjor "Mbi organizimin e Ushtrisë Kombëtare", urdhërohet përhapja në pozicione zjarri e tre baterive të AKA-së, në portet Durrës, Shëngjin dhe Sarandë dhe kjo datë shënon krijimin e Mbrojtjes Ajrore shqiptare. Në këtë kohë Ushtria Kombëtare shqiptare kishte 680 oficerë, 540 nënoficerë, 5800 ushtarë, por edhe 820 kuaj, si dhe asete e pajisje të tjera modeste.

Artileria simbolike e kësaj periudhe ishte modeste por shënoi lindjen e një arme të re, që do të konsolidohej në dekadat që do të pasonin. Lindja e Mbrojtjes Ajrore shqiptare përkon me qeverinë e Pandeli Evangjelit, që ishte qeveria e 28 shqiptare që prej qeverisë së Ismail Qemal Bej Vlorës të vitit 1912-1914. Komandant i Mbrojtjes Kombëtare shqiptare ishte Xhemal Aranitasi; ndërsa Shef i Shtabit të Përgjithshëm ose shef i shtatmadhorisë shqiptare ishte Gjeneral Divizioni Gustav Von Myrdach, i ftuar nga Mbretëria për të shërbyer dhe dhënë përvojën e tij në ushtrinë shqiptare. Armatimi dhe pajisjet e fillimit ishin modeste dhe që nuk plotësonin nevojat reale të mbrojtjes ajrore, çka u vërtetua me agresionin e prillit 1939, ku rezistenca ishte e papërfillshme dhe krejtësisht e pamjaftueshme, që coi edhe në pushtimin e vendit dhe bashkimin e ushtrive.

## **Mbrojtja Ajrore u rigjallërua dhe u vu në provë edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare**

Përgjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, 1939-1944, mjetet e mbrojtjes nga ajri qenë efikase në zbulimin e asgjësimitin e avionëve dhe luajtën rol përcaktues në zhvillimin e luftimeve. Ndërsa në Shqipëri, në kuadrin e betejave dhe operacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, elementët e mbrojtjes nga rreziku ajror erdhën duke u përsosur nëpërmjet zbatimit të masave të maskimit, vrojtimit ajror dhe kundërveprimit me armët e lehta të këmbësorisë dhe me ato të marra armikut, ose armët trofe. Zbatimi efikas i këtyre masave çoi në rrëzimin e një avioni nga partizanët e Pezës dhe të një avioni tjetër nga partizanët e çetës partizane të Mallkastrës. Gjatë luftës nuk munguan edhe rrëzime të tjera të avionëve, që duhet thënë ishin edhe aksidentale dhe rrjedhojë e zhvillimit të ulët teknologjik. Nga ajri erdhën mysafirë të ftuar e të paf-tuar, që synonin asgjësimitin e lëvizjes çlirimtare, si dhe aviacioni i aleatëve anglez e amerikan në ndihmë të Shqipërisë. Por sërish historiografia pranon modestësisht zhvillimin e MKA-së gjatë këtyre viteve të vështira e komplekse të luftës.

### **Misionare dhe e suksesshme arma e MKA-së në mbi gjysëm shekulli**

Më 1945-1946, pas përfundimit të luftës, u bë grumbullimi i armëve kundërajrore trofe dhe u krijua shkolla e instruksionit të AKA. Ndërkohë një numër kuadros të rinj u dërguan për t'u përgatitur në shkollat ushtarake jashtë shtetit. Më 14 shkurt 1946 krijohet kompaia e VAIN-it, me detyrë vrojtimitin e hapësirës ajrore dhe informimin për objektet ajrore të zbuluara. Kjo ka hyrë në historikun e Mbrojtjes Ajrore si data e krijimit të Regjimentit të parë të Zbulimit Elektronik. Kjo ka qenë dhe ngelet një datë historike. Në fakt vitet e para pas çlirimit ishin edhe vitet kur pati edhe ndryshyeshmëri më të shpeshta strukturash, që u përputhën me strukturat e modeleve jugosllave dhe sovjetike. Viti 1946 pati ristrukturimin e dytë të kryer me urdhër A-1-66 "Tepër rezervat" i dt. 5.3.1946, që në fakt fillimi i organizimit u krye me urdhër Nr. A-1-218 "Rezervat" datë 2.4.1946. Ky urdhër vendosi në



funksionim Komandën e Artilerisë, e cila u suprimua po brenda vitit 1946 me urdhër nr. M-8, "Tepër rezervat" datë 23.9.1946. Në muajt prill dhe maj 1955, u arrit kompletimi me radarë llokativë të tipave P-8, P-10, P-20 dhe më 25 maj 1955 u krijua Batalioni Radioteknik, i cili u përhap në të gjithë territorin administrativ të vendit. Kjo shënon edhe krijimin e VKQ (Vendkomanda Qendrore), QOSA (Qendra Operacionale e Survejimit Ajror), që aktualisht është emërtuar Qendra e Kontroll Raportimit (QKR). Ngjarja që "kundërajërorësit" e llogarisnin gjithmonë me peshë ka qenë ajo e 14.11.1947 kur krijohet regjimenti i l-rë kundërajror në kryeqytet. Ky regjiment shërbeu si një shkollë e rëndësishme për përgatitjen e kuadrove të parë të Mbrojtjes Kundërajrore shqiptare (MKA-së). Pajisja në vazhdimësi me teknike të re dhe me kuadro të kualifikur në shkollat tona ushtarake dhe ato jashtë vendit krijoi kushte për konsolidimin e mëtejshëm të Mbrojtjes Kundërajrore-MKA. Me një shpejtësi të konsiderueshme në pak vite u futën në armatim topat 57 m/m, 100 m/m, me drejtim automatik, topat 37 m/m dygrykësh, me shenjestra automatike si dhe mitralozët 14,5 m/m katërtgrykësh. Mbrojtja kundërajrore u pa si një detyrë e veçantë dhe me mjaft rëndësi edhe në dekadat që pasuan. Në periudhën 1959 deri 1970 u shënua krijimin dhe konsolidimi i njësisë së vetme të raketave kundërajrore, që u bënë arma më speciale kundërajrore. Pajisja me raketa të drejtuara kundërajrore dhe radarë të zbulimit të largët e fuqizuan padyshim së tepërmi mbrojtjen ajrore shqiptare. Në ditën e përvjetorit të pavarësisë më 28 nëntor 1960 u vendos në pozicion zjarri grupi i parë i raketave të drejtuara kundërajrore; ndërsa më 6.12.1968 u krijua Regjimenti i Raketave të

Drejtuara kundërajrore (RDKA). Është gjithashtu fakt se Shqipëria pas viteve 1970 kishte rreth 22 regjimente të Artilerisë Kundërajrore (AKA-së) si dhe 18 batalione mitraliere të AKA-së, që llogarisnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit të mbrojtjes shqiptare. Në vitet 1967-1972 sipas zhvillimeve ushtarake e kryesisht bazuar në dokumentacionin arkivor, mund të thuhet se shënojnë kulmin e zhvillimit të Mbrojtjes Ajrore, e cila pajiset me teknike të re dhe që shënon nivele të reja në përgatitje ushtarake e sidomos në gatishmëri. Në këtë periudhë gjysëmshekullore që është një ndër periudhat me të ndritura e më me shkëlqim të Mbrojtjes Kundërajrore shqiptare, ka pasur edhe leadershipin që ka drejtuar me efikasitet, gjeneralë dhe komandantë të shquar që në këtë shkrim mund të përmendim: Rrahman Parllaku, Arif Hasko Mema (Tërbaçi), Sejdin Avdia, Halim Ramohito, Maqo Zoto, Kiço Janku, Naum Gjinikasi, Pali Prifti, Ylli Dimraj, Mehmet Metko, etj. Por Komanda e Mbrojtjes Ajrore ka pasur edhe mjaftë ushtarake të zotë që kanë spikatur në armën e Mbrojtjes ajrore dhe që kanë bërë emër si, Skënder Malindi, Maqo Zoto, Kiço Janku, Naum Gjinikasi, Arif Hasko, Rahman Parllaku, Halim Ramohito, Sejdin Avdia, Bejto Isufi, Jani Isaia, Pali Prifti, Fadil Toçi, Ylli Dimraj e shumë të tjerë. Njerëzit i japin jetë historisë dhe shtrirja me "Gjashtë gryka zjarri për çdo kilometër të frontit të mbrojtjes shqiptare", flet më shumë se njëmijë fjalë.

### **Ristrukturimi i MKA-së efektiv për kohën dhe kompleksiteti i problemeve**

Në vitet 1991-1992, dhe me vendosjen e demokracisë në Shqipëri si dhe me hapjen e vendit, u

bë kërkesë e kohës ristrukturimi i ushtrisë dhe i Mbrojtjes Ajrore shqiptare. Si masë kryesore fillestare u gjykua përqëndrimi i mjeteve dhe kalimi në struktura drejtimi të reja dhe më efikase. Në atë kohë kishte 22 regjimente kundërajrore, 126 grupe të Artilerisë Kundërajrore-AKA e batalione të Mit-KA me rreth 1300 nënreparte duke përfshirë edhe togat e Mit-KA 12.7 m/m. Nuk kishte fshat i Republikës pa rojen operative të gatishmërisë luftarake të armatosur (ROGL), që kishte mitrolozin e tij kundërajrorë. Në vitin 1998 me riorganizimin që u bë ushtrisë shqiptare sipas modeleve perëndimore, krijohet Forca Ajrore dhe Mbrojtja Ajrore ingranohet në këtë strukturë. Gjithashtu në vitin në 1998, Mbrojtja Ajrore dha një kontribut të veçantë për fitoren e luftën në Kosovë, me vrojtimin e pandërprerë të hapësirës ajrore dhe lehtësitë aeroportuale për gjithë aviacionin e NATO-s, i cili pati një impakt pozitiv në arritjen e objektivave të këtij operacioni luftarak historik. Gjithashtu përgjatë viteve të fundit janë bërë përpjekje dhe janë shënuar rezultatet e para të modernizimit të Mbrojtjes Ajrore, në përshtatje me strukturat organizative të ushtrive të NATO-s. Mbrojtja Ajrore është në procesin e strukturimit që synon pajisjen e saj me sisteme e mjete, të cilat disponohen nga ushtritë anëtare të NATO-s, me qëllim arritjen e standarteve të kërkuara nga anëtarësimi në NATO. Vizioni dhe e ardhmja e Forcës Ajrore synon transformimin dhe modernizimin e Mbrojtjes dhe Vëzhgimit Ajror, duke rritur më tej bashkëpunimin dhe ndërveprueshmërinë me vendet e NATO-s. Prioritetet kryesore të modernizimit janë, ndërtimi i një sistemi të vëzhgimit ajror të integruar me sistemin e NATO-s (NATINADS), kontrollin dhe menaxhimin e hapësirës ajrore së bashku me Aviacionin Civil. Detyrat strukturat e Mbrojtjes Ajrore i realizojnë në mënyrë të standardizuar, duke arritur të kemi një siguri më të lartë të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë, kjo edhe falë kontributit të vendeve anëtare të NATO-s, koordinatoreve tanë që punojnë në qendrat operacionale, si dhe bashkëpunimit me ANTA-n. Por nga ana tjetër një rol të rëndësishëm në ecjen përpara dhe konsolidimin e Mbrojtjes Ajrore shqiptare ka luajtur dhe vazhdon të

luajë trajnimi i personelit në shkollat perëndimore të NATO-s dhe të vendeve partnere.

### **Mbrojtja Kundër Ajrore në "pushtetin" e lartësive gjeografike shqiptare**

MKA-ja ka punuar gjithmonë me logjikën smart të kuptimit dhe zbatimit të misionit. Ajo ka qenë e ndërgjegjshme misionin e vështirë dhe të njohur për sakrificat të panumërta të efektivitetit të saj. Mbrojtja Kundërajrore shqiptare dhe Aviacioni shqiptar janë "takuar, ndarë e ritakuar" disa herë përsa i përket formës organizative e vartësisë strukturore, megjithëse duhet thënë se bashkëpunimi i tyre ka qenë gjithnjë i pashtëputur. Fakt është se që në fillimet e saj, arma e Aviacionit ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore, gjë që ka vazhduar deri në vitin 1974 për t'u bashkuar përsëri në Forcat e Mbrojtjes Ajrore në vitin 1995. Komandanti i parë i Aviacionit ka qenë zoti Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974. Nga viti 1975 e deri në vitin 1995, komandantë të Aviacionit kanë qenë Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Perlat Binaj. Por sikurse shkruam edhe më lartë shumë ushtarakë të këtyre armëve, që kanë drejtuar e punuar në vite, janë nga figurat më të shquara të ushtrisë sonë kombëtare ku me krenari mund të përmendim Rrahman Parllaku, Gjin Marku, Hito Çako, Todi Naço, Sotir Filto, Arif Hasko, Edip Ohri, Niko Hoxha, Babaçe Faiku, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Haki Jupasi, Perlat Binaj, Salih Dibra, Haki Jupasi, Stefan Kaggjini, Lulo Musai, Perikli Teta, Foto Lako, Harilla Rebi, Perlat Sula, Astrit Jaupi, Vait Gollkja, Dilaver Goxhaj, Gëzdar Stroka, etj, të cilët kanë qenë të njohur në të gjithë radhët e ushtrisë për kryerjen e detyrave. E megjithatë jo të gjithë i përkasin armës së MKA, por shërbimi në aviacionin luftarak shqiptar ka qenë pazgjydhshëmrisht me detyrat që kryenin "kundërajrorësit" në shërbim të mbrojtjes së hapësirës ajrore shqiptare. "Kundërajrorësit" kanë qenë "pushtuesit" e çdo maje në hapësirën shqiptare, në gjysëmshekulli, që bashkë me misionin kushtetues janë përballur me qindra vështirësi jetese e shërbimi dhe që kanë ditur të përballonjë

sfida dhe të triumfojnë mbi to në ditë të bardha por dhe në ditë rreziku. Në ditë feste kundërajrorësit kujtojnë komandantin e parë të Mbrojtjes Kundërajrore Gjeneral Gjin Markun të lindur më 2.6.1918 në fshatin Bazë të Mirditës dhe që më 15.4.1955, me krijimin e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore të shtetit emërohet komandant i saj. Ai është shpallur "Qytetar Nderi" i Mirditës dhe hero i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në vitet që pasuan MKA-në e kanë komanduar Sotir Filto (1955-1956); Arif Hasko (1959-1966); Todi Naço (1967-1969); Bejto Isufi (1969-1971); Kiço Janku (1972-1975); Naum Gjiniçasi (1975-1982); Pali Prifti (1982-1992); Ylli Dimraj (1992-1995). Më vonë komandantë të FMA kanë qenë edhe Perlat Sula, Agim Baruti. Por të një rangu komandimi dhe drejtimi për një kohë prej tre dekadash (1.5.1966 deri 28.11.1991) kanë qenë edhe komisarët e MKA-së Rrahman Parllaku, Ilo Prifti, Xhemal Shehu, Halim Ramohitaj, Sejdin Avdia, Qani Duro, Simon Lesko, Paskal Budo, që kanë qenë ushtarakë të nderuar dhe respektuar dhe që kanë dhënë kontribut të spikatur në ngritjen e konsolidimin e MKA-së. Mbrojtja Kundërajrore sëbashku me Aviacionin Luftarak si dhe me repartet e Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (VHA) pavarësisht nga format organizative të ndryshme në vite e dekada kanë qenë gjithnjë të lidhura e në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, por edhe me lidhje varësie e strukturore të ndryshme me njëra-tjetrën në vite. Ato i më shumë i ka "takuar" se sa "ndarë" misioni kushtetues i shenjtë që me të drejtë ka merituar respektin dhe mirënjohjen e mbarë popullit. Është kjo arsyeja që respekti e mirëshohja shkon për "kundërajrorësit" në këtë ditë të 86 vjetorit të armës së MKA-së shqiptare. Ata ecnin dhe ecnin me hapin e kohës tashmë si strukturë e konsoliduar, e standardizuar dhe e përbashkuar në Komandën e Forcës Ajrore, drejtues dhe lider të së cilës janë ushtarakët në detyrë Kolonel Edison Zarka si dhe stafi i tij, Kolonel Genci Petani, dhe shumë ushtarakë të lartë të të gjitha gradave ushtarake të përkushtuar në misionin e tyre kombëtar dhe përgjegjësitë e detyrave në kuadër Euroatlantik.





**M**inistri i Mbrojtjes i Kosovës Anton Quni, ka zhvilluar një bisedë telefonike me ministrin e mbrojtjes të Republikës së Malit të Zi Predrag Boshkoviç. Në frymë miqësie e partneriteti, të dy ministrat kanë biseduar për nivelin e bashkëpunimit të deritashëm dhe shkallën e implementimit të marrëveshjes bilaterale në mes dy ministrive.

Ndër të tjera, ata diskutuan për procesin e menaxhimit të pandemisë COVID-19 në nivele shtetërore, strategjitë e dy ministrive, operacionet e forcave gjatë emergjencës si dhe sfidat e shfaqura gjatë luftimit të saj. Ata vlerësuan se kjo krizë ka qenë sprovë e veçantë dhe se mësimet e nxjerra do të shërbejnë efektshëm në përbalimin sa më të suksesshëm të pandemisë përkatëse dhe krizave të ngjashme në të ardhmen. Të dy ministrat u dakorduan në intensifikimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve dhe kapaciteteve në mes të dy ministrive dhe forcave në mënyrë që me sinergji të përballohet dhe mposhtet suksesshëm kriza e përmasave tashmë globale.

Specifikat e përbashkëta të dy vendeve dhe fqinjësia e mirë, sikur për situatën e krijuar nga COVID-19, mundëson lehtësisht dhe efektshëm shkëmbimin e përvojave, si dhe shkëmbimin sipas nevojave të ndërsjella të aftësive e kapaciteteve njerëzore e teknike të specializuar për mbështetje reciproke në mes dy vendeve. Të dy u pajtuan që pas pandemisë, kontaktet të intensifikohen me vizita të ndërsjella për të thelluar bashkëpunimin bilateral në të mire të paqes dhe sigurisë së dy vendeve si dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.



MINISTRI ANTON QUNI-HOMOLOGU MALAZES PREDRAG BOSHKOVIÇ

## Kosovë-Mali i Zi: Bashkëpunim për rritjen e kapaciteteve midis dy ministrive

Do të intensifikohen kontanket e ndërsjella për të thelluar bashkëpunimin bilateral në të mire të paqes dhe sigurisë së dy vendeve si dhe stabilitetit rajonal



# Shërbimi ushtarak sipas përvojës së disa vendeve të NATO-s

**M**inistri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Anton Quni, i cili edhe në Qeverinë e re të drejtuar nga Abadulla Hori, tha se duhet të merret në considerate nisja e shërbimit ushtarak. Ai në mbledhjen e parë të Qeverisë Hoti ku u paraqit programi i qeverisë, Ministri Quni tha se përvoja e disa vendeve të NATO-s për shërbim ushtarak është e mirë dhe duhet të praktikohet edhe në Kosovë.

“Në lidhje me fushën e sigurisë do të ishte mirë që të jetë në konsideratë, për momentin specifikat, prania ndërkombëtare ushtarake këtu dhe disa dokumente që ne duhet të ju referohemi pasi që FSK-ja është në fazën e tranzicionit që bazohet në planin gjithëpërfshirës”. “Për një bashkëpunim ndërinstitucional që Kosova të jetë anëtare e NATO-s janë disa standarde që duhet t’iu përmbahemi edhe në lidhje me shërbimin obligativ ushtarak, që është pjesë e programit qeverisës pasi që kemi përvoja të mira të disa anëtarëve të NATO-s që e praktikojnë këtë shërbim. Unë e kam përgati-

Përvoja e disa vendeve të NATO-s për shërbim ushtarak është e mirë dhe duhet të praktikohet edhe në Kosovë

tur një material që do t’ua dërgoj dhe shpresoj të merret në konsideratë”, tha ministri Quni në mbledhjen parë të kabinetit qeveritar.

Po kush është Anton Quni, karriera e tij ushtarake e politike gjatë luftës e pas saj. Anton Quni, ka lindur më 9.6.1967 në fshatin Fshaj të Gjakovës. Ai ka mbaruar shkollën fillore “At Gjergj Fishta”, Bishtazhin-Gjakovë, shkollën e Mesme Ushtarake në Beograd dhe Akademinë Ushtarake në Beograd/Sarajevë. Quni është i martuar me Mirjanen e cila është kroate dhe së bashku kanë katër fëmijë, tre djem e një vajzë. Zotëron tre gjuhë të huaja: Angleze, Serbe dhe Kroate.

Pas përfundimit të studimeve në Akademinë Ushtarake në Beograd/Sarajevë (1986-1990), ai për një periudhë të shkurtër (1990-1991), punon si Komandant i Kompanisë në Ushtrinë e Jugosllavisë nga e cila dezertoi. Ne vitin 1998 angazhohet si Komandant i Batalionit të UÇK-së,

kurse ne vitin 1999 si Shef i Stafit i Brigadës “Agim Ramadani” të UÇK-së dhe me clirimin e kosoves si Shef i Shtabit i Qendrës për Trajnim Kolektiv të TMK-së, për të vazhduar deri ne vitin 2009 si Shef i Shtabit i Komandës për Trajnim dhe Doktrinë. Ka realizuar disa trajnime në fushën e sigurisë, organizuar nga NATO, KFOR-ri, DICAF.

Më pas Quni la ushtrinë për ta vazhduar karrierën politike aktivisht në Lidhjen Demokratike të Kosovës, për të garuar në zgjedhje për postin e deputetit të Kuvendit të Kosovës. Ai mori besimin e qytetarëve në katër zgjedhje parlamentare në vitin 2010, 2014, 2017 dhe 2019 duke përfaqësuar qytetarët në Kuvendin e Kosovës. Në qeverinë e dalë nga zgjedhjet e fundit, qeveria Kurti, zoti Quni mbajti postin e ministrit të Mbrojtjes, post të cilin po mban edhe në qeverinë Hoti.

## Gjeneral brigade Harris mbaron misionin si shef i Shtabit të KFOR-it

**M**inistri i Mbrojtjes Anton Quni i shoqëruar nga Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Prahman Rama dhe shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, morën pjesë në ceremoninë lamtumirëse të shefit të Shtabit të KFOR-it gjeneral brigade Shawn A. Harris i mbajtur në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it në Film City. Në pritjen personale lamtumirëse, gjeneral Harris i shoqëruar nga

pasardhësi i tij gjeneral Larry Henry, falënderoi ministrin Quni dhe gjeneral Ramën për bashkëpunimin e ngushtë dhe u uroi suksese në realizimin e objektivave të synuar në zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri Quni e falënderoi gjeneralin amerikan dhe shprehu mirënjohjen e thellë për bashkëpunimin e ngushtë dhe të suksesshëm gjatë mandatit të tij në

detyrën tejet të rëndësishme siç është përgjegjësia e Shefit të Shtabit të KFOR-it. Ministri Quni dhe gjeneral Rama i uruan gjeneral Harris-it suksese në detyrat dhe përgjegjësitë e reja në kuadër të forcave mike amerikane si dhe përgëzuan pasardhësin e tij gjeneral Henry-n duke shprehur gatishmërinë e plotë për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në të ardhmen në mes FSK-së dhe KFOR-it.





MINISTRI QUNI MERR MESAZH URIMI NGA HOMOLOGU TURK AKAR

## Turqia do mbështesë realizimin e objektivave të MM dhe FSK

**KFOR: 21 vite kontribut për paqen dhe stabilitetin rajonal**

**M**inistri i Mbrojtjes Anton Quni priti atasheun ushtarak të Turqisë në Kosovë, kolonel Ismail Cenkeri Ersoz. Duke e falënderuar për vizitën, edhe këtë herë, Ministri Quni shprehu mirënjohjen për mbështetjen e madhe në të gjitha aspektet që ka ofruar dhe vazhdon të ofroj qeveria dhe ushtria turke në ndërtimin e FSK-së dhe perspektivën zhvillimore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nga ana e tij, Kolonel Ersoz, e falënderoi ministrin Quni për mikpritjen dhe solli letrën me mesazhin e urimit për detyrën e ministrit nga ana e Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Turqisë Hulusi Akar si dhe ambasadorit të Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar.

Në mesazhet e urimeve, theksohet intensifikimi i bashkëpunimit bilateral dhe fuqizimi i partneritetit si dhe shprehet vullneti i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave Turke për vazhdimin e përkrahjes në të gjitha fushat në funksion të realizimit të objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nga ana e tij Ministri Quni, shprehu kënaqësinë për urimet me mesazhet miqësore dhe vullnetin për vizita të ndërsjella me homologun Akar si dhe thellimin e bashkëpunimit bilateral duke vlerësuar lart rolin e Turqisë si vend anëtar i NATO-s në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Në këtë takim Kolonel Ersoz shoqërohej nga këshilltari ushtarak i Ministrit të Mbrojtjes dhe Komandantit të FSK-së nga FA të Turqisë, Kolonel Mehmet Kurtpinar.

**M**ë 12 qershor 2020, Forca e Kosovës e udhëhequr nga NATO (KFOR) shënoi përvjetorin e 21-të. Misioni i KFOR-it mbetet i pandryshuar. Bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB, rreth 3400 trupa të siguruara nga 27 anëtarë dhe partnerë të NATO-s vazhdojnë të kontribuojnë në mirëmbajtjen e një mjedisi të mbrojtur dhe të sigurt në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes për të gjitha komunitetet në Kosovë.

Për më shumë se dy dekada, KFOR ka dhënë një kontribut të madh për stabilitetin dhe sigurinë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. NATO gjithashtu vazhdon të ofrojë mbështetje të fortë politike për dialogun e lehtësuar nga BE midis Beogradit-Prishtinës, si mënyra e vetme për të siguruar një zgjidhje të qëndrueshme për të konsoliduar stabilitetin rajonal.

Që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19, KFOR ka ruajtur aftësinë e tij për të kryer operacionet e përditshme. Në të njëjtën kohë, KFOR ka ofruar ndihmë për institucionet lokale në Kosovë për komunitete dhe komuna të ndryshme, duke përfshirë dhurimin e sasive të konsiderueshme të pajisjeve mbrojtëse personale. KFOR ka zbatuar plotësisht masat parandaluese të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetit për mbrojtjen e personelit ushtarak.





# Gjeneral Rama priti kadetët e përzgjedhur për studime në SHBA

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim kadetët e FSK-së të përzgjedhur për studime në gjeneratën 2020-2024 në akademitë ushtarake të SHBA-së, respektivisht Akademinë Ushtarake prestigjioze West Point dhe Akademinë e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të shoqëruar nga Atasheu i Mbrojtjes së SHBA-së në Kosovë Kolonel Ryan Nichols dhe Shefja e Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes së SHBA-së, Major Courtney Olson.

Në takim Gjeneral Rama shprehu kënaqësinë dhe përgëzimet për rezultatet më të mira në testim si dhe përzgjedhjen e tyre në bazë të kriterëve standarde të përcaktuara të akademive përkatëse në konkurrencë shumë të fortë. Ai, ndër të tjera bashkë me urimet shprehu edhe besimin e plotë në suksese të larta në studime për katër vitet e ardhshme, sukses që reflekton në vlerat e FSK-së, shtetit tonë, dhe vlerat e partneritetit strategjik me



aleatët tanë amerikan.

Për suksesin e kadetëve Vesa Ibrahim dhe Andrin Vuthaj të Akademisë Ushtarake West Point dhe kadetit Albin Bytyqi i Akademisë së Forcave Ajrore, i pari kadet në këtë akademi nga FSK, Gjeneral Rama, falënderoi dhe shprehu mirënjohjen e thellë ndaj Ambasadës mike amerikane të përfaqësuar në këtë takim nga Kolonel Nichols dhe Major Olson për kontributin në realizimin e kësaj mundësie

dhe këtij suksesi shumë të madh për FSK-në dhe Kosovën në përgjithësi. Në takim, Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama shoqërohej nga Drejtori i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Euroatlantike të Ministrisë së Mbrojtjes, Kolonel Hasan Hoxha dhe këshilltari ushtarak në Kabinetin e Komandantit të FSK-së, Major Jaser Mulla.

## Me rastin e 21 vjetorit të çlirimit të Kosovës

### Në kujtim të ushtarëve të rënë të NATO-s dhe KFOR-it në Kosovë

Me rastin e 21 vjetorit të çlirimit të Kosovës, datës së 12 qershorit që është data historike e çlirimit të Kosovës, Ministri i Mbrojtjes z. Anton Quni së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarin e përgjithshëm z. Faruk Geci, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj dhe oficerë të lartë të FSK-së, bënë homazhe dhe vendosën lule tek pllaka përkujtimore e ushtarëve të rënë të KFOR-it, shtatorja e Presidentit

historik Ibrahim Rugova dhe heroit të luftës së UÇK-së Zahir Pajaziti.

Në ditën e çlirimit, në shenjë respekti dhe falënderimi për kontributin e NATO-s, në çlirimin e Kosovës për krah Ushtrisë Çlirimtare, Ministri dhe Komandanti me bashkëpunëtorë, te pllaka përkujtimore e ushtarëve të rënë të NATO-s, KFOR-it gjatë misionit në Kosovë, vendosën buqeta me lule. Po ashtu në ditën e çlirimit, sot kur Kosova është shtet i lirë dhe i pavarur, Ministri dhe Ko-

mandanti me bashkëpunëtorë, bënë homazhe dhe vendosën buqeta me lule para shtatorës së presidentit historik Ibrahim Rugova, në shenjë nderimi dhe respekti të veprës jetësore, të kontributit politik në orientimin e politikës kosovare drejtë aleancës euroatlantike. Po ashtu Ministri dhe Komandanti me bashkëpunëtorë, në ditën e çlirimit të Kosovës, në shenjë nderimi dhe respekti, për kontributin, sakrificën dhe rënien heroike, bënë homazhe dhe vendosën buqeta me lule te shtatorja e Heroit të Kosovës, luftëtarit të orëve të para të UÇK-së Zahir Pajaziti.



**F**SK-së i shtohet edhe një oficer i lartë me diplomë të akademisë ushtarake të SHBA-ve. Oficeri i lartë i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) koloneli Sylejman Cakaj, i cili gati një jetë të tërë është në uniformë ushtarake dhe si i tillë i ka shërbyer atdheut, ka kryer me sukses të shkëlqyeshëm studimet në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes të SHBA-ve, në Washington D.C, dhe morri diplomën e Masterit të Studimeve Strategjike të Sigurisë, si dhe diplomën e Shkollimit Profesional Ushtarak (JPME II) të SHBA-ve. Gjithashtu nga kolegji „CISA“, ka marrë çmimin „Student i dalluar.“ Ceremonia solemne u organizua më 11 qershor nga “National Defense University” (NDU), në Washington DC, të SHBA-ve. NDU është njëri ndër universitetet më prestigjioze në fushën e mbrojtjes në SHBA.

Kolonel Cakaj, para se të shkonte për studime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka kryer detyrën e komandantit i Regjimentit të III-të të Komandës së Forcës Tokësore (KFT) në Mitrovicë. Gjatë studimeve, koloneli Cakaj, është dalluar me paraqitjen e shkëlqyeshme në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes në Washington D.C.

Ai, gjithashtu me sukses të lartë ka mbrojtur temën e Masterit të studimeve strategjike të sigurisë, dhe njëherësh për paraqitjen e mirë shpallet „Student i dalluar“ nga kolegji CISA. Për gjithë të arriturat, koloneli Cakaj, ka falënderuar FSK-në, për përkrahjen pa rezervë, familjen dhe shokët e tij. Ai, premtoi se përvojën ushtarake të fituar në SHBA, do ta përcjellë tek ushtarët e tij në Forcën e Sigurisë së Kosovës. E tani koloneli Cakaj ka fituar edhe një përvojë amerikane dhe me atë pritjet të



UNIVERSITETI KOMBËTAR I MBROJTJES TË SHBA-VE, WASHINGTON D.C.

## Koloneli Cakaj diplomohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kolonel Sylejman Cakaj, ka marrë diplomën e Masterit të Studimeve Strategjike të Sigurisë, diplomën e Shkollimit Profesional Ushtarak të SHBA-së (JPME II) dhe nga Kolegji CISA ka marrë çmimin “Student i dalluar”

kthehet e t'i shërbejë atdheut.

Ja postimi në facebook nga vetë Sulejman Cakaj me 11 qershor 2020: “Të dashur familjar, miq dhe kolegë, sot perfundova studimet e avancuara në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes së SHBA-së në Washington DC dhe mora diplomën e Masterit të Studimeve Strategjike të Sigurisë dhe diplomën e Shkollimit Profesional Ushtarak të SHBA-së (JPME II). Gjithashtu, nga Kolegji CISA kam marrë çmimin “Student i dalluar.” Për të gjithë këto të arritura falënderoj shumë familjen time për mbështetjen e përzërvë gjatë gjithë kohës. Gjithashtu, falënderoj stafin drejtues të FSK-së për mbështetjen e vazhdueshme. Gjithë ky sukses do të ishte i pamundur pa luftën dhe sakrificën e heronjëve tanë, andaj edhe këtë çmim të fituar u'a dedikoj dëshmorëve të UÇK-së”.

Sylejman Cakaj, ka shërbyer si ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai ishte pjesë aktive e shumë betejave të suksesshme të realizuara nga njësia Speciale Diverzanto- Vëzhguese “Arbëri”, e

udhëhequr nga strategu luftarak, Dëshmori i Kombit, Tahir Sinani, e cila funksiononte në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Brigada 121 “Ismet Jashari-Kumanova”.



**P**as studimeve 4-vjeçare në akademinë ushtarake më prestigjioze në SHBA dhe në botë, e njohur edhe si West Point, me traditë 218 vjeçare, dy kadetët e FSK-së, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku, diplomuan me sukses të lartë. Suksesi i kadetëve kosovarë është i veçantë pasi që për herë të parë në akademinë ushtarake prestigjioze të West Pointit në SHBA, u diplomuan dy kadetë nga Kosova.

Kjo akademi u themelua që në vitin 1802, si kolegji i parë i inxhinierisë në Amerikë, i cili edhe sot vazhdon të jetë institucioni kryesor i zhvillimit udhëheqës në botë, i radhitur vazhdimisht në mesin e kolegjeve më të mira në vend.

E veçanta e kësaj ngjarje është edhe fakti se në ceremoninë e veçantë të diplomimit këtë vit, të shtunën më 13 qershor 2020, mbajti fjalimin edhe Presidenti i SHBA-së Donald Trump i cili u tha të sapo-diplomuarve të Akademisë Ushtarake, West Point se detyra e tyre do të ishte të mbronin interesat jetike të Amerikës dhe jo të luftonin në lufta pa fund në toka të largëta.

Ceremonia e diplomimit u mbajt nën masat për parandalimin e pandemisë COVID-19 që pamundësoi pjesëmarrjen e mysafirëve, familjarëve të kadetëve dhe publikut të gjerë. Në mesin e 1100 kadetëve të diplomuar në këtë gjeneratë, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku, janë dy oficerët e rinj të FSK-së të cilët njohuritë profesionale dhe akademike për doktrinën e taktikave ushtarake më të avancuara në botë do t'i zbatojnë me ushtarët dhe nënoficerët e FSK-së edhe përshtypjet për rëndësinë e ngjarjes dhe suksesit ishin të veçanta nga të dy kadetët.

Kadetët e FSK-së, Arelena Shala dhe Ylli Dalladaku

## Dy kadetët e FSK-së diplomohen në Akademinë amerikane West Point

Për herë të parë në akademinë ushtarake prestigjioze të West Pointit në SHBA, u diplomuan dy kadetë nga Kosova

"Mbi të gjitha kjo ditë më ka ngjall ndienja krenarie pasi e kam pasur nderin ta përfaqësoj vendin në një skenë ndërkombëtare si West Pointi. Motoja me të cilën kthehem në Kosovë është: - detyra, nderi, atdheu e cila rrit ndienjen e përgjegjësisë për t'i kontribuar vendit tim", - theksoi kadete Arelena Shala, si gruaja e parë shqiptare që diplomohet në një akademi ushtarake në fushën e inteligjencës gjeo-hapësinore.

Kurse Ylli Dalladaku për inxhinieri dhe aeronautikë, thotë se njohuritë e fituara në West Point i ka të ndërhuara mbi vlerat e detyrës, nderit dhe atdheut si faktorët kryesor të suksesit për çdo ushtri. "Unë do të punoj dhe do të punoj jashtëzakonisht shumë që të udhëheq dhe inspiroj tregun tim dhe të udhëheq me shembull duke i ofruar kompetencë, dedikim ndaj detyrës dhe disiplinë", - theksoi në fund kadet Dalladaku. Kadetët e FSK kanë përfaqësuar denjësisht Kosovën dhe FSK-në, duke u radhitur në 5 për qindëshin e studentëve me rezultatet më të mira në klasën e tyre.

Suksesi i tyre është njëherësh edhe mirënjohja e vlerësimi më i mirë

për mbështetjen jetike të SHBA-së dhe forcave të saj, si aleatët tanë të pazëvendësueshëm. Në këtë aspekt, kjo mbështetje vazhdon edhe me pranimin e tre kadetë të rinj që këtë vit fillojnë shkollimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga të cilët dy në West Point dhe për herë të parë një kadet në Forcat Ajrore të SHBA-së.

Misioni i Akademisë Ushtarake Amerikane "West Point" vazhdon të mbetet edukimi, stërvitja dhe frymëzimi i korpusit të kadetëve, në mënyrë që çdo i diplomuar të jetë një drejtues i përkushtuar ndaj detyrës, nderit dhe vendit, si dhe i përgatitur për një karrierë të përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj kombit. Ligji i Shteteve të Bashkuara, lejon deri në 60 kadetë nga vendet e huaja të studiojnë në Akademinë Ushtarake, e cila ka 4400 kadetë, dhe arsimimi i tyre sponsorizohet nga qeveritë përkatëse. Akademia Ushtarake e SHBA-ve në West Point është një kolegji katërvjeçar, bashkëedukues, federativ, liberal i arteve, i vendosur 50 milje në veri të Nju Jorkut.

## Dy nënoficerë përfunduan kursin e rreshter majorëve në SHBA

**R**adhëve të rreshter majorëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të cilët kryen kursin e rreshter majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), më 19 qershor 2020, iu shtuan edhe Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani, të cilët përfunduan me sukses Kursin e Rreshter Majorëve në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për Nënoficerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Bazën Fort Bliss në El Paso në Teksas.

Ky institucion më herët ka qenë i njohur si Akademia e Rreshter

Majorëve. Kursi i Rreshter Majorëve është program 12 mujor, që përgatit Rreshter-Major, për principet e lidershit, për udhëheqjen e trupës së nënoficerëve, për këshillimin e nivelit të lartë të oficerëve lidhur me funksionimin e trupës së nënoficerëve, për ekzekutimin e operacioneve të përbashkëta tokësore, duke përfshirë të gjitha degët e ushtrisë Amerikane si dhe operacionet ndërkombëtare në bashkëpunim me agjenci të ndryshme. Shkollimi i oficerëve të FSK-së, është mbështetur nga Zyra për Mbrojtje dhe Bashkëpunim pranë Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë.

Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani gjatë shkollimit në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për Nënoficerë në SHBA, treguan disiplinë, angazhim dhe profesionalizëm, si dhe e përfunduan me sukses të lartë Kursin e Rreshter Majorëve, klasa 70.

Diplomimi i dy rreshter majorëve në përgjithësi është një e arritur e radhës për FSK-në, ku deri më tani në këtë Akademi të rreshter majorëve, kanë diplomuar me sukses të dalluar gjithsej shtatë oficerë të FSK-së.



## Forcat Ajrore Greke do patrullojnë qiellin e Maqedonisë së Veriut

**D**ita e sotme tregoi se çfarë do të thotë të jesh anëtar i NATO-s. Kjo do të thotë të kemi aeroplanët e NATO-s, në këtë rast nga Forcat Ajrore Greke, duke ruajtur dhe patrulluar qiellin tonë, që sot ishte një rastësi e madhe me festimin e Ditës së WING-ut të Forcave Ajrore. Pikërisht në ditën kur njësi feston jubileun e saj, kemi ditën kur është kryer ky policim ajror. “Kjo është një fushë në të cilën Maqedonia e Veriut ka parë integrimin e saj të parë të plotë në strukturat e NATO-s,” tha ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska sot në një ceremoni që shënon Ditën e WING-ut të Forcave Ajrore, gjatë së cilës misioni i patrullimit ajror të NATO-s fluturoi mbi qiellin tonë, ndërsa Armata jonë gjithashtu paraqiti demonstrim të kapaciteteve fluturuese.

Duke theksuar gatishmërinë për investime si në personel ashtu edhe në pajisje për këtë segment të rëndësishëm, ministrja theksoi se qëllimi është të përmirësohen kushtet e punës në WING të Forcave Ajrore dhe të zvogëlohet dallimi në kapacitete dhe pajisje me anëtarët e tjerë të NATO-s. “Ne kemi arritur të rrisim seriozisht të ardhurat e të gjithë pjesëtarëve të WING aviacionit të cilët specializohen në aviacion. Jam e lumtur që arritëm të kthejmë disa ushtarë ish-pjesëtarë të Armatës, por gjithashtu për atë se arritëm të sigurojmë për të gjithë të rinjtë dhe më me përvojë paga të rritura midis 30 dhe 60 përqind, ose të shprehura në shuma, disa që tejkalojnë 100,000 denarë, të cilat janë disa nga të ardhurat më të larta në Armatë. Ekziston një rritje e pagave për ushtarët profesionistë, të cilët tre muaj më parë kishin të ardhura mu-

Ministrja Shekerinska: Kjo është një fushë në të cilën Maqedonia e Veriut ka parë integrimin e saj të parë të plotë në strukturat e NATO-s



jore 30,000 denarë, ndërsa tani rreth 46,000 denarë, dhe secila gradë më e lartë do të thotë një ndryshim edhe më i madh në të ardhurat mujore, tani dhe tre vjet më parë”, tha Shekerinska.

Ministrja falënderoi Armatën për angazhimin e saj në luftën kundër koronavirusit dhe uroi për sondazhin e fundit të opinionit

publik që tregoi se qytetarët kishin besimin më të lartë në Armatë. “Ky besim nuk është pa arsye, por ai është ndërtuar me çdo vendim për të ndihmuar shtetin dhe çdo qytetar,” tha ministrja, duke u uruar pilotëve tanë ushtarak një qiell të qetë kur drejtojnë avionët e Forcave Ajrore WING.



# Poligoni ushtarak “Krivollak” në funksion të aleatëve të NATO-s

**M**inistrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nënkolonel Vasko Gjurchinovski, së bashku me Shefin e Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes në Ambasadën Amerikane, nënkolonel Den Majeda, inspektuan punimet për ndërtimin e poligonit “Krivollak” ku Batalioni Inxhinierik i Armatës rindërton infrastrukturën rrugore dhe hap rrugë të reja.

„Poligoni Ushtarak Krivollak është një burim i shkëlqyeshëm për Armatën tonë, por poligoni ushtarak i Krivollakut do të jetë gjithashtu një burim i shkëlqyeshëm për Aleancën e NATO-s. Me investimet që ne po bëjmë tashmë, me modernizimin që po planifikojmë me forcat tona dhe me mbështetjen e ushtrisë amerikane, jam e bindur që poligoni ushtarak Krivollak do të jetë terreni më i mirë për stërvitjet e NATO-s në kontinentin Evropian”, tha ministrja Shekerinska dhe shtoi se ky poligon stërvitës jep përgjigjen për atë se çka mund t’i ofrojë vendi ynë Aleancës së NATO-s.

„Ne tregojmë se sa të rëndësishëm janë njësitë inxhinierike brenda Armatës, të cilët praktikisht, në bazë të forcave të tyre, arrijnë të ndërtojnë infrastrukturë në Krivollak. Me këtë infrastrukturë, ne do të rrisim lëvizshmërinë brenda poligonit, por gjithashtu do të rrisim kapacitetin për kryerjen e stërvitjeve që me të vërtetë do të jenë në një nivel që vendet e tjera nuk e kanë dhe nuk mund t’ia lejojnë vetes. Unë pres që ky të jetë një burim për Armatën tonë, do të jetë një burim për NATO-n, por gjithashtu do të jetë një burim për zhvillimin lokal sepse me mundësinë për të kryer stërvitje të shkëlqyera këtu do të kemi më shumë konsum dhe më shumë interes nga më shumë ushtri të NATO-s.

Ministrja Shekerinska uroi pjesëtarët e njëjësive inxhinierike të cilët me mekanizimin e ri i realizuan

“ Shekerinska: “Poligoni ushtarak “Krivollak” i cili po ndërtohet me mbështetjen e ushtrisë amerikane, do të jetë poligoni më i mirë për stërvitjet e NATO-s në kontinentin Evropian”



shpejt detyrat. Se sa modernizimi rrit kapacitetin e poligonit ushtarak të Krivollakut do të shihet vitin e ardhshëm kur një pjesë e stërvitjes më të madhe në Evropë “Defender” do të realizohet në vendin tonë me pjesëmarrjen e ushtrive aleate-tha Shekerinska. „Mendoj se kjo tregon aftësinë e Armatës sonë dhe nuk është rastësi që ajo tashmë është një ushtri e NATO-s”. Komandanti i Batalionit të Inxhinierisë nënkolonel Tome Peev tha se batalioni ka punuar për 30 ditë për ndërtimin e një infrastrukture të re dhe rikonstruksionin e infrastrukturës ekzistuese të PU Krivollak në mënyrë që të sigurojë një sistem anashkalimi rreth perimetrit të kufirit të PU Krivollak dhe lidhje të brendshme në gjatësi prej 75 km.

Lidhur me atë se a rrezikohet ekologjia nga ndërtimi i poligonit “Krivollak”, ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, tha se “Ne e patëm këtë diskutim vitin e kaluar dhe nuk donim të mbeten vetëm

fjalë, por donim të bisedonim me fakte dhe të dhëna. Kështu që vitin e kaluar, për herë të parë në historinë e Armatës sonë, kemi pasur monitorim të vazhdueshëm të të gjithë parametrave mjedisore gjatë një stërvitjeje. Dhe bazuar në atë bashkëpunim me komunitetin akademik në shtetin tonë, kemi treguar se stërvitjet e atij kalibri, me të njëjtën madhësi si vitin e kaluar, nuk shkaktojnë ndonjë ndikim negativ, sepse morëm të gjitha masat e mbrojtjes. Jam e sigurt se do të bëhet standard, që në pothuajse çdo stërvitje madhore do të kemi monitorim të të gjithë parametrave mjedisorë”, theksoi zëvendëskryeministrja Shekerinska. Qytetarët, shtoi ajo, mund të mbështeten te Armata që i mbron ata nga rreziku, i mbron ata nga epidemitë, duke i mbrojtur edhe gjatë krizave, “derisa nuk i rrezikojnë përmes mjedisit jetësorë dhe numrat e tregojnë këtë”.



# NATO luan rol të rëndësishëm në mbështetjen e vendeve anëtare

**A**leatët e NATO-s, përfshirë Maqedoninë e Veriut, miratuan një plan të ri operacional për të trajtuar pandeminë, si dhe një vendim për krijimin e një fondi të përbashkët për të mbuluar nevojat urgjente të shteteve anëtare, dhe për të krijuar furnizime të pajisjeve mjekësore, informoi ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska pas seancës së dytë të mbledhjes ministrore të Këshillit të Atlantikut të Veriut, më 18 qershor 2020.

“Të 30 aleatët po përballen me të njëjtin problem, dhe kjo është një pandemi që tashmë ka një shkallë globale, kështu që mënyra më e mirë dhe më efektive është që të kemi një pozicion të vetëm, një përgjigje të koordinuar, të jemi solidar në ndihmë, por edhe të shpejtë për të reaguar”, -tha ministrja Shekerinska. Ajo sqaroi se fondi i përbashkët do të përdoret për prokurimin dhe sigurimin e pajisjeve mjekësore, transportin e pajisjeve, pacientëve dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor, ndërsa rezervat do të krijohen përmes prokurimit nga ky fond, si dhe nga donacionet nga vendet anëtare.

Ministrja theksoi se NATO deri më tani ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e vendeve anëtare, por edhe vendeve partnere në trajtimin e virusit, duke transportuar pajisje mjekësore kritike dhe duke vendosur pothuajse 100 spitale për terren. Ky angazhim, tha ministrja, në shumë mënyra ishte i ngjashëm me angazhimin e Armatës sonë, si në aspektin e mbështetjes së institucioneve civile, por edhe në aspekt të shfrytëzimit të kapacitetit të spitalit mobil.

“Nëse dikush ka patur ndonjë dyshim, ja edhe saktësisht se çfarë do të thotë të jesh pjesë e Ale-



ancës. Kjo nënkupton pjesëmarrjen në vendime, por edhe përdorimin e përfitimeve të një veprimi të tillë të organizuar dhe solidaritetit. Kjo do të thotë që ne nuk jemi vetëm dhe se nuk jemi të vegjël, por se jemi pjesë e aleancës me të vërtetë më të fuqishme ushtarake-politike. Ne jemi pjesë e një familje më të madhe që mbështetet mes veti dhe ndihmon sa herë që nevojitet kjo ndihmë”, -tha ministrja Sekerinska.

Në pyetje gazetari për blerjen e

uniformave të reja për pjesëtarët e Armatës, ministrja theksoi se është duke u zgjidhur një çështje që nuk është zgjidhur për shumë vite. “Jam vërtet e kënaqur që më në fund ushtarët mund të ndiejnë se janë vlerësuar nga vendi i tyre, sepse kanë paga më të larta, sepse kanë kompensime të rritura dhe sepse kur të veshin uniformën e vendit të tyre, ata do të ndjehen krenarë, të kënaqur dhe të vlerësuar”, - tha ministrja Shekerinska.



# Armata maqedonase është një partner i besueshëm

Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Azim Nuredin, mori pjesë në mbledhjen e Zëvendës Shefave të Ushtrive të vendeve anëtare të “SEDM”

Takimi i rregullt vjetor i Zëvendës Shefave të Shtabeve të ushtrive të shteteve anëtare të Nismës për Bashkëpunim të Ministrave të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM) u mbajt përmes telekonferencës me video në Bukuresht-Rumani, për shkak të masave për të parandaluar përhapjen e virusit KOVID-19. Në fjalën e tij, Zëvendës Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore, gjeneralmajor Azim Nuredin, theksoi angazhimin e armatës maqedonase, si shtet i 30-të anëtar i NATO-s dhe një partner i provuar, për të përmbushur të gjitha detyrimet e vendit pritës në vitet e ardhshme, në selinë e komandës së brigadës.

Takimi prezantoi aktivitetet më të rëndësishme të procesit SEDM në vitin e kaluar, si dhe aktivitetet e Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), me theks në gatishmërinë e komandës së brigadës për zhvendosjen e saj nga Larisa, Greqi në Kumanovo, Maqedonia e Veriut. Është planifikuar që kalimi të realizohet në gusht të këtij viti, ku për të cilin të pranishmit ka referuar komandanti i brigadës, gjeneral brigade Tudorika Petrache. Ndër të tjera, në takim u diskutua për situatën dhe ndikimin e pandemisë KOVID-19 në rajon, si dhe stërvitjen e ardhshme simuluese të SEESIM-20 të ushtrive të shteteve anëtare të SEDM, e cila është caktuar për në nëntor 2020 në Veles, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Kryetari i Komitetit Politik dhe Usharak të SEDM, dhe Zëvendës Ministri aktual i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Petro Koci, gjithashtu iu drejtuan pjesëmarrësve dhe rëndësinë e procesit të SEDM për sigurinë rajonale.



Përveç Republikës së Maqedonisë Veriore, Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Greqia, Gjeorgjia, Italia, Rumania, Shtetet e Bashkuara, Sllovenia, Serbia, Turqia, Ukraina, Kroacia dhe Mali i Zi, mërën pjesë në iniciativën SEDM. Kurse Moldavia ka statusin e vëzhguesit. Procesi

SEDMI u iniciua nga Shtetet e Bashkuara në 1996 në Tiranë, me qëllim forcimin e mirëkuptimit, bashkëpunimit politik dhe ushtarak dhe përmirësimin e stabilitetit dhe sigurisë në rajon me angazhimin e plotë për parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial të të gjitha vendeve anëtare.

## Maqedonia pjesë e Qendrës Europiane për trajnimin e pilotëve

Ministria e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, së bashku me 10 ministra të tjerë të mbrojtjes nga vendet anëtare të Aleancës, nënshkruan një letër qëllimi për të filluar një iniciativë shumëkombëshe për krijimin e një strukture për trajnime fluturimi të NATO-s në Evropë.

Kjo iniciativë do të mundësojë krijimin e një rrjeti të Qendrave të Trajnimit të Pilotëve që do të plotësojnë nevojat e disa aleatëve në trajnimin e pilotëve evropian, të cilët vetë nuk zhvillojnë kësi lloji kapaciteti. Ky rrjet do të ketë një ndërvëprim akoma më të madh midis aleatëve, do të zvogëlojë koston e trajnimit të pilotëve dhe është një shembull i vërtetë i konceptit të ndarjes së ngarkesave midis vendeve anëtare të NATO-s. Maqedonia e Veriut në këtë iniciativë përfshin Qendrën e Trajnimit të Pilotëve, e cila përfshin dy simuluesit e modernizuar për helikopterët Mi-17 dhe Mi-24. Ministrat e mbrojtjes të Bullgarisë, Kroacisë, Republikës Çeke, Greqisë, Hungarisë, Malit të Zi, Portugalisë, Rumanisë, Spanjës, Turqisë dhe ministria Shekerinska nënshkruan letrën e qëllimit praktikisht menjëherë pas takimit ministror të NATO-s.

Nënshkruhet kontrata ndërshtetërore 3.2 milionë euro

## Dy helikopterë Bell 505 Jet Ranger X nga kanadezja "CCC"

Me një shpejtësi prej 232 km/orë dhe një ngarkesë prej 680 kg, Bell 505, unikë në Ballkanin Perëndimor, është projektuar të jetë i sigurt dhe i lehtë për të fluturuar

**M**inistria e Mbrojtjes e Malit të Zi ka nënshkruar më 5 qershor 2020 një kontratë ndërshtetërore për furnizimin e dy helikopterëve Bell 505 Jet Ranger X, me Kompaninë Kanadeze Tregtare 'CCC'. Kontrata nënkupton që kompania do të sigurojë trajnime në Francë për tre pilotët nga Mali i Zi, si dhe për tetë teknikë në Akademinë Bell Training, në Fort Worth- Texas.

"Ministria e Mbrojtjes së Malit të Zi vazhdon me punë të përkushtuar për të përmirësuar forcat e armatosura. Në prag të tre vjetorit të anëtarësimit në NATO, kjo Marrëveshje konfirmon se Mali i Zi është i përkushtuar dhe bën gjithçka që të jetë gati për sfida të reja", tha Ministri i Mbrojtjes Predrag Boskoviç. "Me avionë të tillë, unikë në Ballkanin Perëndimor, ne do t'u ofrojmë pilotëve tanë trajnime të shkëlqyera, por edhe mundësinë për të kryer detyra të ndryshme," theksoi Ministri Boskoviç.

Me një shpejtësi prej 232 km/orë dhe një ngarkesë prej 680 kg, Bell 505 është projektuar të jetë i sigurt dhe i lehtë për të fluturuar. Dizajni vë në plan të parë sigurinë, performancën dhe përballueshmërinë, duke kombinuar sistemet e provës me teknologjinë e përparuar dhe një pamje të hijshme dhe moderne.

"Ne jemi krenarë që kemi një Bell 505 të ri në ekstradilin tonë, i cili është i pajisur me teknologjinë më të fundit," tha koloneli Nenad Pavlovic nga Forcat Ajrore të Malit të Zi. "Këta helikopterë do t'i lejojnë pilotët tanë të kryejnë detyrat e tyre më mirë, veçanërisht si pjesë e misionit të tretë për të ndihmuar popullsinë."

Bell 505, sipas drejtuesve kryesorë nga ajo kompani, është një sukses i madh në Evropë dhe pjesë të tjera të botës.

"Ne jemi krenarë që i sigurojmë Forcave Ajrore Malazeze produkte dhe shërbime të jashtëzakonshme. Bell 505 është një aeroplan fenomenal për trajnimin e pilotëve të rinj ushtarakë". Falënderojmë Forcën Ajrore të Malit të Zi për pajisjen e skuadronit të saj me helikopterë Bell, dhe Bell 505 do të jetë një



shitesë e shkëlqyeshme për atë program", tha Duncan Van De Velde, Drejtori i Përgjithshëm për Evropën dhe Rusinë. Avioni përfshin një kabinë të teknologjisë së lartë dhe një model fleksibel të kabinës, që e bën atë jashtëzakonisht konkurrues me kosto dhe të aftë për të gjitha sfidat.

Një helikopter Bell 505 do të arrijë në Mal të Zi muajin tjetër, dhe një tjetër në fillim të 2021. Vlera totale e prokurimit është 3,267,234,77 euro. Sipas Marrëveshjes, helikopterët do të dorëzohen në Mal të Zi nga zyra e përfaqësimit Bell në Pragë.

**D**rejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Politikë dhe Planifikim të Mbrojtjes, gjeneralmajor Rajko Pesic dhe i Dërguari i Mbrojtjes i Republikës së Francës, koloneli Fabrice Duda, nënshkruan Planin e Bashkëpunimit Bilateral midis Malit të Zi dhe Francës në fushën e mbrojtjes për vitin 2020.

Takimi midis Gjeneral Major Peçiç dhe Kolonel Duda ishte një mundësi për të rishikuar bashkëpunimin aktual të mbrojtjes midis Malit të Zi dhe Francës, siç dëshmohet nga zbatimi i suksesshëm i aktiviteteve të shumta të para-

shikuara nga planet e mëparshme të bashkëpunimit dypalësh. Pesic shprehu kënaqësi për takimin dhe vlerësoi përpjekjet që Duda po investon në mirëmbajtjen e marrëdhënieve cilësore midis dy vendeve, si dhe forcimin e intensitetit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. Gjithashtu, Pesic foli për rolin e rëndësishëm që Ushtria e Malit të Zi luajti në luftën kundër pandemisë së re të koronavirusit, duke punuar çdo ditë në sigurimin e karantinës dhe dekontaminimit të automjeteve dhe objekteve mjekësore dhe zonave, si dhe për organizimin e

Në ditën e dytë të mbledhjes së Këshillit të Atlantikut të Veriut, më 18 qershor 2020, ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, Predrag Boskoviç mori pjesë në një seancë kushtuar përgjigjes ndaj krizës së shkaktuar nga virusi COVID-19. Gjatë takimit, ministrat deklaruan se, përkundër sfidave të shumta me të cilat përballen të gjitha vendet për shkak të pasojave të shkaktuara nga COVID-19, NATO vazhdon të kryejë me përgjegjësi dhe me sukses detyrat e planifikuara me qëllim të ruajtjes së sigurisë së territorit të saj dhe qytetarëve.

Ministrat theksuan se kriza COVID-19 tregoi unitetin dhe rezistencën e të gjithë aleatëve, të cilët, përmes ofrimit të ndihmës, treguan solidaritet dhe angazhim të ndërsjellë për ruajtjen e vlerave të përbashkëta. Ata pajtohen që është e rëndësishme të informoni publikun në kohën e duhur dhe të besueshme për të gjitha aktivitetet e kryera, në mënyrë që të shmangen pasojat e përhapjes së dezinformatave. Ministri Bozkoviç theksoi se kriza e shkaktuar nga koronavirusi, përveç solidaritetit të lartë në luftën për të ruajtur shëndetin e popullatës, tregoi rëndësinë e një qasjeje të bashkuar të të gjithë aleatëve në trajtimin e përhapjes së dezinformatave.

Boskoviç deklaroi se NATO-ja

## Bashkëpunimi me partnerët është thelbësor për sigurinë globale

Vendet anëtare të NATO-s duhet të punojnë së bashku për të identifikuar dhe kundërshtuar sfidat e kohës



duhet të punojë së bashku për të identifikuar dhe kundërshtuar këto sfida. Ministri tha se në periudhën e kaluar, u confirmua se Aleanca mbetet e përkushtuar për vlerat e saj thelbësore, duke marrë parasysh që aleatët kanë bërë përpjekje

të konsiderueshme për të zvogëluar pasojat për jetën e njerëzve. Ministri theksoi gjithashtu rëndësinë e kapaciteteve ushtarake si mbështetje në zbatimin e masave kombëtare për të eliminuar pasojat e koronavirusit.

Ai gjithashtu deklaroi se bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, kryesisht BE dhe KB, është i një rëndësie thelbësore në përpjekjet e përbashkëta, si në ruajtjen e paqes dhe sigurisë globale, ashtu edhe në gjetjen e zgjidhjeve më të mira për të luftuar pandeminë.

Ministri Bozkoviç shprehu mirënjohjen për të gjithë aleatët, të cilët, në mënyrë bilaterale ose përmes Qendrës Koordinuese të Urgjencës Euro-Atlantike (EADRCC), i dhanë mbështetje Malit të Zi në formën e materialeve dhe pajisjeve mjekësore dhe në këtë mënyrë dha një përgjigje adekuate për sfidat e pandemisë, që është një tjetër konfirmim i solidaritetit dhe miqësisë.

## Mali i Zi-Francë: Nënshkruhet marrëveshja ushtarake për vitin 2020

evakuimit mjekësor.

Ai shprehu kënaqësi për bashkëpunimin gjithëpërfshirës midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, dhe theksoi se ai do të vazhdojë të mbrojë për përmirësimin e tij të mëtejshëm në të ardhmen. Ai gjithashtu theksoi angazhimin e rëndësishëm të ushtrisë malazeze gjatë epidemisë së virusit Covid-19, i cili kontribuoi shumë në përfundimin e suksesshëm të

luftës kundër virusit dhe falë të cilit Mali i Zi u bë zyrtarisht një nga vendet e para pa raste aktive në Evropë.

Në takim u diskutua për pjesëmarrjen e tanishme të anëtarëve të ushtrisë malazeze në misionet ndërkombëtare, si dhe për punën e vazhdueshme për modernizimin dhe pajisjen e Ushtrisë dhe forcimin e kapaciteteve të saj në mënyrë që të përmbushin detyri-

met e marra që dalin nga agjenda e NATO-s. Bashkëbiseduesit ranë dakord që nënshkrimi i Planit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes midis dy ministrive ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të mbrojtjes si vende aleate brenda Aleancës, dhe theksuan se ata do të punojnë për të zhvilluar modalitete për mirëmbajtjen dhe periudha e ardhshme



